



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 205/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 19.11.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **2 dhjetor 2024 (e hënë), me fillim në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 tetor 2024.
2. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2023/2024 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2024/2025.
3. Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.
4. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, me numër të protokollit 01.178/16 i datës 29.09.2016.
5. Informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
6. Informatë lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal.
7. Informatë për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë.
8. Propozim-vendim për caktimin e normave tatimore të pronave.
9. Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.121/24 i datës 27.06.2024, për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Futbollit "Vushtrria".
10. Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.153/24 i datës 25.07.2024, për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Hendbollit KHF "Samadrexha".
11. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës



Bujar Klinaku

From: Melihate Basholli Latifi
Sent: 19 November 2024 15:58
To: Bastri Duraku; Bujar Klinaku
Subject: Fwd: Kërkesë për shtyerje të seancës

Sent from my iPhone


Begin forwarded message:

From: Ferit Idrizi <Ferit.Idrizi@rks-gov.net>
Date: 17 November 2024 at 12:34:12 CET
To: Melihate Basholli Latifi <melihate.basholli.latifi@rks-gov.net>
Cc: Bujar Shatrolli <bujar.shatrolli@rks-gov.net>, Hava Mlinaku <hava.mlinaku@rks-gov.net>
Subject: Kërkesë për shtyerje të seancës

E nderuara Kryesuese,
Për shkak të festave të Nëntorit, kërkoj nga ju që seancen e Kuvendit Komunal, ta shtyeni për të hënë, me 2 dhjetor.

Me respekt,
Ferit Idrizi

Sent from my Galaxy



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 15.11.2024

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **15 nëntor 2024** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2023/2024 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2024/2025.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të bashkëngjitet lista e shfrytëzuesve të pronës komunale se kush janë përfituesit, a i kanë kryer obligimet financiare ndaj komunës shfrytëzuesit e pronës komunale, nëse ka pasur shkëputje të kontratave këtë vit apo vitin e kaluar, të bashkëngjiten me material dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizim të vendimit të Kuvendit të Komunës.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të bashkëngjitet lista e bizneseve të shuara, vendet ku kanë kryer aktivitet ekonomik dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
6. Shqyrtimi i Informatës për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e normave tatimore të pronave.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të bashkëngjitet vendimi i vitit të kaluar dhe të bëhen krahasime si dhe të përgatitet në formë grafike (sllajde) gjendja paraprake, duke krahasuar me gjendjen që po propozohet për vitin e ardhshëm dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E IX E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 31 TETOR, 2024

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:20**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Alban Bajrami, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Fatmire Cecelia, Jeton Gjaka, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mek Selaci, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Spasoje Stefanoviç, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mungoi: Fakete Dushi,

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë të gjithë anëtarët e zgjedhur të kuvendit dhe kuorumi është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- në fillim të mbledhjes, prezantoi një pikë shtesë të rendit të ditës, për shqyrtim, kërkesë, për mbështetje financiare.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-në adresimin e tij para rendit të ditës paraqiti një kërkesës për kryetarin e komunës dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, që ka të bëjë me memorandumin e bashkëpunimit që ka nënshkruar kryetari i komunës me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, lidhur me rikonstruktimin e katër rrugëve, por që specifik kërkesa e tij ka të bëjë me rrugën Akrashticë-Balincë, në të cilën projekt fatkeqësisht me apo pa qëllim me apo pa dashje nuk është përfshirë segmenti i rrugës “Qazim Morina” në gjatësi për afër 900 metra. Prandaj kërkesa e tij për kryetarin e komunës është që të ndërmarr veprime, që Drejtoria e Urbanizmit të hartoi projektin dhe kësisoj të bëj thirrje dhe të adresoi kërkesën te përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, që me një aneks-kontratë të trajtohet edhe segmenti i rr.”Qazim Morina”. Është me rëndësi që projektet me fondet me bashkëfinancim të jenë të barabarta dhe të shtrihen në të gjitha lagjet, ashtu që të arrihet efekti për përmbushjen e interesit të përgjithshëm qytetar.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-në adresimin e tij para kuvendit deklaroi se, qeverisja aktuale e Vushtrrisë për këto tri vite ka prodhuar vetëm pluhur dhe kaos, kjo për faktin se në cilindo drejtim që futesh në Vushtri ballafaqohesh me kaos si rezultat i shkatërrimit të rrugëve dhe infrastrukturës që është dëmtuar në masë. Të gjitha këto projekte nuk e di se si i ka menduar qeverisja aktuale, por projektet rëndom bëhen për t'iu lehtësuar jetën qytetarëve e jo për t'ua vështirësuar. Projektet që po zhvillohen në qytet po bëhen duke u zgjeruar rrugët dhe po eliminohen apo zhduken trotualet dhe po ngushtohen hapësirat publike siç është rasti te parku i qytetit. Nëse i shkojmë këto projektet kryesore siç është rr."Bekim Berisha-Abeja", atëherë ky projekt ka pasur të përfundoi në muajin tetor 2024 dhe është shtyrë edhe për 6 muaj tjerë dhe kjo vërtet është shkatërruese për ata banorë, dhe po ashtu është e turpshme. Lidhur me këtë projekt duhet të njoftohen qytetarë se përse po kemi gjithë këto vonesa, sepse kjo për bëhet për shkak të neglizhencës dhe diskrepancave dhe mos përgjegjësisë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e tij pra kuvendit dhe qytetarëve të komunës së Vushtrrisë, ngriti shqetësimin e kryetarëve të këshillave lokal, që për vitin e dytë me radhë nuk janë duke iu kompensuar pagesat për punën e tyre edhe pse këtë gjë e mundëson ligji dhe udhëzimi administrativ, prandaj kërkoj nga drejtoria përgjegjëse që procedoj me zbatimin e këtyre pagesave për këta përfaqësues. Po ashtu ngriti shqetësimin e fermerëve të Komunës së Vushtrrisë, që edhe pse iu është premtuar për vitin 2024 nuk iu është kompensuar subvencioni prej 0.5 centë për litër të qumështit. Se si është gjendja me mirëmbajtjen e hapësirave publike më së miri e ka treguar takimi që patëm me kryetarin e komunës në emisionin "Jeta në Komunë", ku shpërfaqet qartë dështimin në mirëmbajtjen e hapësirave publike. Pastaj gjendja me ndriçimin publik në qytet dhe në shumë fshatra është e rëndë, Kompania "Përparimi" ndonëse e ka obligim mirëmbajtjen e këtij ndriçimi ajo po dështon në ofrimin dhe mirëmbajtjen e këtyre shërbimeve publike për qytetaret e komunës. Kjo dëshmohet se në fshatin Gracë edhe pse ekziston rrejtja, atje dritat e ndriçimit nuk funksionojnë fare, në Stanoc të Epërm në rr. Dalip Maloku, Skender Bllac, Hamdi Hasani, mandej Rr. Jeta, Myrvete Haradinaj dhe rr.Ibrahim Pronaj dhe shumë rrugë tjera ndonëse ekziston rrjeti, nuk mirëmbahen dritat edhe pse është obligim i Kompanisë nuk mirëmbahet ndriçimi publik. Në fshatin Druar, kemi mungesë të ndriçimit publik në rrugët "Fronti i UÇK-së", "Dëshmorët e Druarit", "Beteja e Druarit", në fshatin Reznik në rr."Shqip Rrustemi", në Dumnicë të Poshtme në rr. "Mehmet dhe Asllan Bullaku", në Smrekonicë por edhe në të gjitha fshatrat dhe qytet nuk kemi mirëmbajtje të rrugëve, prandaj kërkoj nga kompania përgjegjëse që në afat sa më të shkurtër kohor ta rinovoj rrjetin dhe dritat në sistemin e ndriçimit publik.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit- pyeti kryesuesen e kuvendit se përse ndahet buxheti për zyrën e kuvendit dhe kërkoj një raport të detajuar të shpenzimeve të zyrës së kuvendit për vitin e kaluar dhe për këtë vit, për faktin se anëtarët e kuvendit për gjatë këtyre dy viteve nuk është sa kanë pasur ndonjë vizitë jashtë shtetit, përveç disa servilëve të pushtetit dhe mjetet edhe pse janë shpenzuar, anëtarët e kuvendit nuk janë pajisur me mjete të punës dhe kësaj duhet të dimë se nga po shkojnë këto para, andaj kërkoj që ky raport të bashkëngjitet në seancën e radhës të kuvendit.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-lidhur me pikën shtesë që ka të bëjë me kërkesën për mbështetje financiare, vlerësoi se edhe herëve tjera është kërkuar që këto kërkesa të kalojnë përmes komisioneve përkatëse profesionale dhe të shqyrtohet ana financiare e tyre dhe më pas të sillen për aprovim në kuvend, kështu është vështirë të refuzohen sepse kuvendi po sillet në një pozitë të palakmueshme.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-lidhur me kërkesën për mbështetje financiare, vlerësoi se një kërkesë e tillë nuk mund të procedohet për aprovim, pasi e njëjta nuk është e kompletuar si

duhet sepse asaj i mungon, raporti mjekësor i institucionit publik ashtu siç kërkohet me legjislacionin në fuqi dhe mungon mendimi i konzoliumit mjekësor, lidhur me konstatimet mjekësore digonstike. Një trajtim i tillë mjekësor dhe shërbimi i tillë ofrohet edhe në sektorin publik dhe institucionet publike duhet ta japin një shërbim të tillë për pacientin në fjalë. Andaj nëse një shërbim i tillë ofrohet në institucionet publike atëherë, mendon se ka edhe raste më të rënda që kërkojnë mbështetje financiare për shërim dhe komuna nuk po ka mundësi t'i mbështes për shkak të kufizimeve buxhetore, është mirë të kemi një racionalizim të shpërndarjes së këtyre subvencioneve për të sëmuret.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se duhet të kemi një politikë të drejt dhe të barabartë në shpërndarjen e këtyre subvencioneve për shërim dhe konsideron se do të ishte mirë të kemi një rregullore për këtë çështje ku do të vendoseshin rregulla në ndarjen dhe orientimin e këtyre ndihmave për shërim të atyre që kanë nevojë. Më tej ai përmendi një rast familjar i tij ku për trajtimin e një sëmundje jashtë vendi ka shpenzuar dhjetëra mijëra euro dhe nuk ka marr asnjë ndihmë nga institucionet lokale dhe qendrore.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se, ky kërkesë për ndihmë për shërim, ka ardhur tani në fillim të seancës pa u trajtuar fare dhe po tentohet kësisoj të vihet në lajthitje kuvendi. Kërkoj një sqarim lidhur me këtë material.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-tha se kjo kërkesë ka ardhur ditën djeshme në Drejtorinë e Financave dhe duke marrë për bazë gjendjen e këtij parashtruesit të kërkesës, e ka parë të arsyeshme që kjo kërkesë të procedohet për trajtim dhe aprovim në kuvend.

Në vazhdim, kuvendi pas shqyrtimit të kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për shërim për z. Adem Hasani, kuvendi pas votimit me 9 vota “për” 13 vota “kundër” dhe 4 “abstenime” nuk e aprovoj një kërkesë të tillë për ta shtuar në rendin e ditës.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 shtator 2024.
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2025.
4. Shqyrtimi i Informatës për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
5. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun.
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ “Zëri i RAE”.
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë.
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për përkrahje financiare për botimin e librit “Vushtria në dokumentet osmane”.
9. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.121/24 i datës 27.06.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Futbollit “Vushtria”.

10. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.153/24 i datës 25.07.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Hendbollit KHF “Samadrexha”.
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për faljen e borxheve në taksat afariste për të gjitha bizneset nga 01.01.2000 deri 31.12.2017
12. Pyetje dhe përgjigje.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 shtator 2024.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 shtator 2024.

2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se duke marr për bazë këtë raport del se niveli i shpenzimeve buxhetore për periudhën 9 mujore në shpenzime kapitale del të jetë shumë i ulët në masën vetëm 56%. Në të kundërtën kryetari i komunës vazhdimisht ankohet se nuk ka mjete buxhetore sepse të njëjtat komunës i janë marrë për kontratë kolektive dhe për atë nuk po mundet të kryej obligimet dhe punë që i ka si udhëheqës i komunës. Deri më datën 30 shtator 2024 në investime kapitale janë të pa shfrytëzuara apo të pa shpenzuara mbi 4,660.730 €, e që janë në kuadër të projekteve për vitin 2024 dhe janë të pa përfunduar e që ka rrezik potenciale që këto mjetet do të shkojnë në suficit. Më tej vlerësoi se edhe pjesa tjetër e buxhetit që është shpenzuar në investime kapitale është shpenzuar por nuk ka shkuar në destinacionin e duhur, sepse të njëjta janë shfrytëzuar për ti mbuluar shpenzimet nga vendimet gjyqësore. Më tej shtoi se do të ishte mirë që të ishte prezent kryetari i komunës për të ia dhuruar një kalkulator sepse ai vet nuk është duke e ditur se si dhe sa e ka buxhetin komuna e Vushtrrisë. Pastaj është interesante të konstatohet se kemi rritje të shpenzimeve për disa pozicione si p.sh. akomodimi për vizita zyrtare brenda vendit derisa në vitin 2023 për periudhën e njëjtë kemi vetëm 40 €, për periudhën e njëjtë në vitin 2024 buxheti është shpenzuar mbi 4000 € për të njëjtin destinim. Për udhëtime dhe mëditje jashtë vendit nga 4407 € në vitin 2023 në 12500 € në vitin 2024 është trefishuar dhe nuk dihet se cili është formati dhe përfitimi i këtyre vizitave jashtë vendit. Shpenzimet e telefonisë mobile janë rritur përmbi 4000 € në raport me vitin paraprak, shpenzimet e arsimit dhe trajnimit nga 880 € në 11400 €. Shpenzimet në avokaturë, janë shpenzuar afër 18,000.00 € dhe janë humbur të gjitha lëndët, dhe për 4000 € më shumë se sa në vitin paraprakë. Shërbimet tjera kontraktuese janë rritur përmbi 400.000.00 €. Në fund tha se kryetari i komunës vazhdimisht ankohet se nuk ka buxhet, ndërsa në mënyrë të vazhdueshme i favorizon njerëzit e afërt dhe që e mbështesin si militantë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se arseja e mungesës së kryetarit në këtë seancë është pikërisht diskutimi për raportin e shpenzimit të buxhetit, sepse ai e di mirë sa ka dështuar në menaxhimin e komunës dhe buxhetit të saj. Kjo argumentohet me shifra sepse në vitin 2022 kemi shpenzim të buxhetit vetëm 16% për investime kapitale, në vitin 2023 kemi vetëm 40 %, ndërsa sot jemi në muajin e 11 të vitit 2024 dhe i kemi mbi 4 milion ero të pashpenzuara në investime kapitale. E kemi qytetin në kaos dhe kemi gjithë këto mjetet pashpenzuara dhe kjo gjende është e mjerueshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-vlerësoi se jo vetëm kryetari por edhe gati gjithë drejtore e drejtorive mungojnë në mbledhje të kuvendit dhe kjo tregon më së mirë për punën dhe angazhimin e kësaj qeveria komunale, si dhe vlerësoi se drejtorët e lëshuan seancën pasi u fotografuan. Duke ju referuar raportit ceku se kemi një realizim të shpenzimeve në investime kapitale, por se edhe këto shpenzime nuk e kanë arritur efektin e duhur, sepse nuk kemi kryerje të punëve. Po ashtu nëse iu referohemi tabelave buxhetore shihet se kemi planifikim të projekteve me shuma marramendëse simbolike të mjeteve financiare me shuma minimale prej 0.20 cent, 0.50 cent, 0.70 cent e të ngjashme, dhe këtu po shihet se sa është serioze kjo qeverisje komunale. Tutje duke u ndalur tek arsimi i mesëm i lartë përkatësisht tri shkollat e mesme, ku kanë qenë të planifikuara për këto shkolla më tepër se 200,000.00 €, kurse janë shpenzuar 8158 € prej këtyre mjeteve, apo shprehur në përqindje ky buxhet për këto shkolla është shpenzuar vetëm 3,97%, ndërsa pjesa prej 96% e këtyre mjeteve për këto shkolla ka mbetur e pa shpenzuar, dhe kur kësaj ja shtojmë faktin se kemi kërkesa të shumta nga këto shkolla, kjo del se kemi një menaxhim tejet të dobët. Pastaj nga 19 projekte të planifikuara vetëm 2 projekte janë realizuar, kjo është refleksioni më i mirë i kësaj qeverie sepse kryetar i komunës dhe drejtori i DKA-së e kanë gojën plotë arsim, ndërsa dështimet janë shumë të mëdha.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me raportin nëntëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, duke u përgjigjur në çështjet e ngritur nga anëtarë e kuvendit. Ai njoftoj se përqindja e shpenzimit të buxhetit komunal në totalin e tij është 80% deri në momentin që po flasim. Investimet kapitale janë realizuar në masën 56%, ndërsa kemi edhe 2 muaj deri në fund të këtij viti.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2025.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës dhe dhënies së propozimeve për formimin e këtij komisioni, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Draft-planit të punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025, në përbërjen si në vijim:

1.1 Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit;

1.2 Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit (PDK);

1.3 Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit (LDK);

1.4 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit (LVV);

1.5 Mensur Kastrati, anëtar i kuvendit (AAK);

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të takohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të hartojë draftin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025, dhe të njëjtin duhet t’ia propozojë Kuvendit të komunës për aprovim në mbledhjen e muajit dhjetor 2024.

4. Shqyrtimi i Informatës për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se fakti se mungon kryetari i komunës dhe drejtori kompetent, për Shërbime Publike, tregon më së mirë për përkushtimin e kësaj qeverie për ujin e pijshme si çështje e rëndësisë së veçantë për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Për me keq kjo

informatë si diçka shumë me peshë përmbledhjet me tre apo katër fjali që është për keqardhje. Askund në informatë nuk shënon se sa kemi pasur kyçje në rrjetin e ujësjellësit, kjo sepse nuk kemi pasur asnjë kyçje të vetëm d.m.th. aty ku ka mbet projektin nga mandati i kaluar, nuk është bërë asnjë zhvillim më tutje. Më tej shtroj se cili lokalitet që nga vitin 2021 nuk ka pasur ujë e sot ka asnjë i vetëm.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se kjo informatë për ujin e pijes është vërtet qesharake, e cila përmban dy tri tabela të vogla të cilat nuk lexohen dhe pesë apo gjashtë fjali, kurse vazhdimisht kur e shpjegojmë ujin në kuadër të shkencës së kimisë themi se uji është substanca themelore e jetës. Qytetarë e Komunës së Vushtrrisë, nuk janë duke kërkuar asgjë më shumë se sa ujë të pijes dhe kjo nuk po arrihet dhe nuk e di se a ka diçka më qenësore se sa uji. Tutje në këtë informatë flitet për gjashtë apo shtatë fshatra kinse po provohet të lëshohet uji, ndërsa Vushtrria ka 66 fshatra dhe të flitet kështu është më tepër se qesharake. Kur flasim për ujin është mirë të dilet me statistika, dhe statistikat flasin se në vitin 2020 në mandatin LDK-LVV edhe pse kohë e rënd me pandemi covid-19 ai në cilësinë e kryetari të Këshillit Lokale Stanoc i Epërm ka përcjell gjendjen me ujë ku janë kyçur mbi 700 ekonomi familjare në rrjetin e ujësjellësit. Nga ajo kohë kanë mbetur rreth 100 ekonomi familjare pa u kyçur në rrjet dhe ashtu edhe kanë mbetur edhe sot e asaj dite, nuk është punuar asgjë në këtë drejtim. Në fshatin Gracë nuk kemi ujë të pijes në Druar në pjesën e lartë të fshatit nuk ka ujë ashtu siç ka mbetur nga viti 2021 në tri Dumnicat nuk ka ujë të pijes, në fshatin Dolak po ashtu, në Studime, Maxhunaj, gjithashtu nuk ka asnjë lëvizje për furnizim me ujë të pijes, andaj nuk e di se si kjo qeveri do tu dal përpara qytetarëve. Mandej lidhur me çështjet ambientale, vlerësoi se gjendja me ujëra të zeza dhe kanalizim asnjëherë nuk qenë më e rënd, ku ka problem edhe në fshatin Mihaliq, Stanoc, Druar, Gracë. Mandej lidhur me kanalizimin në fshatin Stanoc i Epërm që kufizohet me fshatin Breznicë, Komuna e Obiliqit është e gatshme të lidhë memorandum bashkëpunimi për përfundimin e këtij projekti.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-vlerësoi se kjo letër që është sjellë si informatë tregon më së mirë se sa është punuar për tri vite për ujin nga qeveria aktuale komunale. Për një vit e gjysmë sa ka udhëhequr DSHP ai në mandatin e kaluar janë bërë 4500 kyçje në rrjetin e ujësjellësit, prej tyre 3000 kanë pasur ujë në momentin e kyçjes. Vetëm në fshatin Bukosh janë bërë afër 300 kyçje të ekonomive familjare. Lidhur me shumën prej 80 €, që kanë participuar qytetarët, sqaroi se i ka ftuar të gjithë kryetarët e fshatrave për të diskutuar, dhe nuk ka qenë kërkesë por ka qenë propozim, dhe gjithë kryetarët e fshatrave kanë qenë pro kësaj takse asnjë nuk ka qenë kundër dhe kështu edhe është vepruar. Andaj në fund ceku se asgjë nuk mund të thotë kjo qeveri për pos që është e pa aftë për ta përfunduar këtë projekt që ka mbetur në gjysmë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se kjo informatë e cila është sjellë në kuvend me dy paragrafë, ku njëri ndër ta fletë për kompetencat e drejtorisë, tregon më së mirë përkushtimin e kësaj qeverie për ujin, e që në fakt kjo informatë është dashur të jetë pika kyçe më e rëndësishme e këtij mandati qeverisës, sepse siç e dimë uji është elementi qenësor i jetës. Pastaj vlerësoi se projekti i ujit është ai që duhet ta turpëroj qeverisjen e PDK-së, sepse është pikërisht kjo parti e cila ka qeverisur më së shumt Komunën e Vushtrrisë, dhe se Lëvizja Vetëvendosje i qëndron me krenari udhëheqjes së Drejtorisë së Shërbimeve Publike për gati tri vite sepse ka punuar jashtëzakonisht shumë, ndërsa në këtë mandat nuk është punuar asgjë dhe po tentohet të lajthitet kuvenda dhe qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Më tej shtoj se për tri vite radhazi kuvendi ka ndarë mjete financiare për projektin e ujësjellësit, dhe përsëri qytetarët nuk kanë ujë, sepse mjetet nuk janë shkuar në destinimin e duhur dhe kjo përbën dështimin më spektakular të qeverisjes Idrizi. Nëse i shikojmë videot e Kryetari Idrizi në balotazh në vitin 2021 aty ai deklaroi e premtoi se për 6 muaj do të shtrihet ujësjellësi në krejt territorin e Komunës së Vushtrrisë, dhe tri vite më pas nuk

është shtrirë rrjeti as edhe në një lagje të vetme dhe ky është dështim madhor i kësaj qeverie. Në fund deklaroi se projekti i sheshit të qytetit dhe ai i ujësjellësit ku janë investuar miliona euro, dhe nuk është bërë asgjë do ta fundosin qeverinë e Ferit Idrizit.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-duke e përmirësuar në përkufizim anëtarin e kuvendit z.Haradinaj, ceku se në përkufizimin e konceptit të ujit është më mirë të thuhet se uji është një kamponim kimik, kjo për faktin se uji përbëhet prej dy elementeve hidrogjenit dhe oksigjenit apo H₂O dhe koncepti më i sakë është se uji është kamponim kimik. Pastaj shtoi se u fol këtu se mandatin e kaluar është kryer kyçja e ujit, por duhet bërë e ditur se mandatin e kaluar qytetarëve iu janë vjedhur nga 80 € për kyçje në rrejt. Në fund ai shkëmbej disa polemika të ashpra me anëtarin e kuvendit z.Adnan Lahu.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- kërkoj nga anëtarët e kuvendit z.Faton Hyseni dhe z.Adnan Lahu, që ti kërkojnë falej njëri tjetrit për ofendimet dhe fryrjet që shkëmbyen mes veti, ashtu që të vazhdojnë punimet e mbledhjes pa përçarje dhe ofendime politike e personale.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se ku ai flet të gjithë nga pushteti i pëshpëritin duke e penguar në fjalën e tij të cilën ia ka siguruar ligji dhe qytetari, dhe kjo edhe nga vetë kryesuesja e kuvendit. Kjo është e papranueshme dhe denigrues, më tej shtoi se nuk e di se ku e ofendoj z.Hyseni, dhe ceku se ofendimet e tij dhe fjalori i tij i përdorur është denigruese dhe kjo edhe nga pozita që ai mban si mësimdhënës, ai nuk pret dhe nuk e do kërkimfaljen e një njeriu si Faton Hyseni. Ai duke iu adresuar qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, ceku se ku dikush thotë se i keni vjedhur 80 € atëherë duhet ofruar fakte, sepse ato mjete janë paguar për kyçje dhe për ujëmatës sikurse apo ngjashëm sikur në rastin e KEDS-it që paguhet ora e energjisë elektrike. Në fund kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që të mbaj rend e jo të mbaj anë sikurse është duke vepruar.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se z.Adnan Lahu është shumë i vogël që ti mbaj atij moral, dhe përsëriti se ato 80 € janë vjedhur sepse janë inkasuar me bllok-paragona dhe mundësia për keqpërdorim ka qenë tejet e madhe, edhe pse ka ekzistuar xhirollogaria e komunës.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se kryesuesja e kuvendit po deklarohet si e anshme, dhe kjo nuk i bënë mirë asaj dhe as kuvendit. Tutje shtoi se për këto vite sa është anëtare e kuvendit problemi kryesor me të cilin është preokupuar është uji i pijes si një element themelor për jetesë. Mënyra se si ka ardhur kjo informatë me një copë letër ku flitet më tepër për kompetencat e drejtorisë, dhe se kjo informatë i ngjanë më tepër një hartimi të shkollës fillore. Ajo kërkoj nga kryetari dhe drejtori kompetent që të bëjnë përpjekje maksimale për ta zgjidhur problemin e ujit të pijes.

Edona Gashi, anëtare e kuvendit-tha se i vjen shumë keq që ka kesi lloj debatesh dhe që po përfshihet në këto debate të nivelit shumë të ulët ku po ofendohen anëtarët e kuvendit njëri me tjetrin, kjo është e papranueshme. Pastaj deklaroi se problemi me mungesë të ujit të pijes është ekzistentë edhe pse pushteti nuk donë ta pranoj një gjë të tillë.

Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-tha se të gjitha këto kyçje në rrjetin e ujësjellësit që po përmenden, nuk do të mund të arriheshin në qoftë se nuk do të ekziston rrjeti dhe fabrika e ujit që është ndërtuar në Vushtrri në kohën e qeverisjes së PDK-së. Më tej pyeti se përse nuk është bërë vendosja e pompave në vendbanimet me relief të lartë në kohën kur janë bërë këto kyçje në mandatin e kaluar.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-njoftoj se faturat e ujit vijën shumë me vonesë, apo pas 3 ose 4 muaj, dhe kështu grumbullohet borxhi, e pastaj bëhet presion tek konsumatorët që të kryhen borxhet apo lëndët dërgohen tek përmbaruesi. Kërkoj që Kompania Ujësjellësi ta kryej punën si duhet që e ka obligim ti sjell faturat për çdo muaj.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-duke ju referuar diskutimit të anëtarit të kuvendit z.Refik Maloku, vlerësoi se fshatrat Maxhunaj, Vilanc, Ropicë dhe Samadrexhë vetëm tani kanë ujë të pijes, dhe se pushteti i kaluar ka bërë kyçje të ekonomive familjare dhe iu ka marr nga 80 € qytetarëve për kyçje, por ujë nuk është lëshuar dhe nuk ka pasur furnizim me ujë të pijes. Çështja tjetër dhe që është katastrofale është se rrjeti i kanalizimit është shtrirë tek shtrati i Lumit, dhe komplet ai investim është kapitale i vdekur, dhe se krejt ata gypa kur ka reshje dalin mbi sipërfaqe të dheut sepse janë vendosur tek shtrati i lumit. Për tu zgjidhur problemi me ujë të pijes, janë vendosur edhe 4 pompa aty ku tereni ka qenë i lartë dhe uji nuk ka shkuar si në Dumnicë, Sfaracak, Ropicë dhe Maxhunaj aty ku nuk ka pasur shtypje të ujit. Në anën tjetër problemi me ujë të pijes nuk është vetëm tash atë e ka përcjellë komunën e Vushtrrisë që nga pas lufta sikur edhe shumë komuna tjera, dhe ne ende po kemi problem në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në të territorin e komunës. Në fund tha se kjo çështje do të marr kohë dhe nëse folët për të kaluarën atëherë del se fabrika e ujit që është ndërtuar në Vushtrri ka qenë një projekt madhor në vlerë prej 5 milion euro që është bërë në kohën e PDK-së.

Nexhat Merovci, UD i drejtorit të Urbanizmit-sqaroi se për rrugën në fshatin Akrahticë, do të bëhet hartimi i projekti dhe do të futen edhe disa segmente tjera në këtë kuadër dhe do të dërgohet projektit në ministri për financim. Tutje sqaroi se duke filluar nga viti 2009 2010 ka filluar projekti i shpërndarjes së ujit të pijes përmes Qeverisë Zvicerane, dhe kryesisht është investuar në shtrirjen e rrjetit kryesor të linjës së rrjetit, pa u bërë analiza hidraulike të depërtimit të ujit në zonat e larta. Ndërtimi i fabrikës së ujit në fshatin Balincë është bërë në vendin e duhur, sepse po të vendosej në një vend tjetër kostoja e ndërtimit dhe mirëmbajtjes do të ishin të papërballueshme. Në vitin 2012 është bërë shpërndarja e gypit maxhistrat të rrjetit të ujësjellësit nga fshati Akrahticë e deri tek fshati Gllavinë, kjo është bërë në bashkëfinancim mes Komunës së Vushtrrisë Qeverisë Zvicerane dhe Qeverisë së Luksemburgut (shtrirja e rrjetit primar është bërë nga qeverisja Mulaku), ndërsa një pjesë rrjetit sekondar është bërë në mandatin e kryetarit Xhafer Tahiri. Ai konsideron dhe arsyeton se taksa participuese prej 80 € nuk ka qenë hajni, por është bërë sepse taksa nga Kompania e Ujësjellësit ka qenë 140 €. Në fund ceku dhe njoftoj se qeveria e kryetarit Idrizi, është duke punuar në shtrirjen e ujësjellësit në pikat më të larta dhe me të vështira, dhe konsideron se gjatë këtij mandati pjesa dërmues e fshatrave dhe e ekonomive familjare do të furnizohen me ujë të pijes.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-pyeti UD të drejtorit të Urbanizmit, se aplikimi i takës prej 80 € për qytetare për kyçje në rrejt të ujësjellësit a ka bazë ligjore, dhe a ka pasur të drejtë që institucioni i komunës të iu drejtohet këshillave të fshatrave, për ti mbledhur paratë në këtë mënyrë. Komuna ka obligim ligjor të ndërtoj rrjetin e ujësjellësit, por jo edhe kyçjet individuale të ekonomive familjare sepse ky është obligim i kompanisë. Në këtë rast janë keqpërdorë Këshillat e Fshatrave, kur është kërkuar që ata ti mbledhin mjetet për participim për kyçje familjare. Ai këmbëngul se ato taksa janë keqpërdorur fillimisht nga ata që i kanë mbledhur, ndoshta jo prej të gjithëve, e më tej ato janë keqpërdorur edhe kur kanë ardhur në komunë sepse nuk kanë shkuar në destinimin e duhur.

Nexhat Merovci, UD i drejtorit të Urbanizmit-vlerësoi se nëse pretendohet dhe ka fakte për keqpërdorimin e atyre taksave, atëherë është mirë që ajo lëndë të shkoj në hetuesi dhe të merr një epilog gjyqësorë.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha se është interes i Kompanisë Ujësjellësi që ekonomitë familjare të kyçen në rrjetin e ujësjellësit. *Tutje ai kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të ia dërgoj një kopje të vendimit për aplikimin e taksës prej 80 € për kyçje në rrjetin e ujësjellësit,*

si dhe të ofroj informacionet e nevojshme zyra ligjore e Komunës se një vendim i tillë a ka bazë ligjore apo jo.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-përsëriti se ajo taksë prej 80 € është paguar në kesh, edhe pse nuk lejohet pagesa në kesh se aty ekziston gjithmonë mundësia për keqpërdorim. Pastaj shtoi se nga kjo taksë kanë qenë të liruara kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së. Por ka ekzistuar edhe një kategori e cila fare nuk ka paguar dhe është kyçur në rrjet të ujësjellësit.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-tha se për funksionimin e kuvendit ekziston një rregullore, por kjo rregullore sot u shkel me qindra here nga ana e Kryesueses së Kuvendit. Ajo vlerësoi se nëse dikush ka fakte për keqpërdorim të parasë publike për taksën prej 80 €, atëherë ai duhet ti drejtohet organeve përkatëse të rendit, andaj propozoj ti kthehemi rendit të ditës.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-duke ju referuar fjalorit të përdorur nga ana e anëtarit të kuvendit z. Faton Hyseni, ceku se një fjalor i tillë është i papranueshëm, dhe ceku se mënyra se si po e udhëheq mbledhjen kryesuesja e kuvendit është jashtë çdo niveli.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit-tha se në kohën kur është bërë pagesa e taksës prej 80€ ai ka qenë Kryetar i Këshillit të fshatit Strofc, dhe njoftoj duke sqaruar se fillimisht ai kishte kundërshtuar për aplikimin e një takse të tillë dhe kishte marrë përgjigje se nuk do të mund të kyçen pa e bërë pagesën e kësaj takse, më pas kishte pasur një rezistencë të fortë për mos pagesën e kësaj takse nga ana e banorëve, dhe kësaj në përfundim kyçjet në rrjetin e ujësjellësit ishin bërë pa paguar këtë taksë, këtu shtrohet pyetja se u bë kyçja pa paguar kur ka qenë obligim pagesa e asaj takse. Është e vërtet se pagesat janë bërë me paragon dhe mundësia për të keqpërdorë ka qenë e madhe dhe është e vërtet që ka pasur keqpërdorim të atyre mjeteve financiare.

5. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-përsëriti duke ringritur çështjen e vendosje së pllakës me mbishkrimin e emrit zyrtarë të Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë me emërtimin zyrtar <Adem Mikullofci>, emërtim i cili akoma edhe pas disa viteve nuk është vendosur në këtë institucion pikërisht për inate politike e partiake. Kërkoj nga Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, që të ndërmerr hapa konkret të menjëhershëm për zbatimin e vendimit të kuvendit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-vlerësoi se Adem Mikullofci, ka qenë një artistë i merituar, dhe për më tepër ka qenë nga Vushtrria, ai është merituar që Teatri i Qytetit ta mbaj emrin e tij, prandaj kërkoj që sa më parë të vendose ajo pllakë në teatër sipas vendimit të kuvendit. Më tej kërkoj informacione se Drejtoria e Kulturës, a ka paraparë mjetet për blerjen e veglave muzikore dhe kostume për shoqëritë kulturore-artistike “Hasan Prishtina” dhe shoqëritë tjera kulturore.

Izet Miftari, drejtor i DKRS-së-sqaroi se në planë të prokurimit është paraparë shpallja e një tenderi, ku do të bëhet vendosja e pllakave e emërtimeve zyrtare për të gjitha institucionet publike, e ndër to edhe Teatri i Qytetit “Adem Mikullofci”. Pastaj njoftoi se me buxhetin për vitin 2025 është janë paraparë mjete për blerjen e veglave muzikore dhe veshjeve kombëtare për shoqëritë kulturo-artistike.

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ “Zëri i RAE”.

Spasoje Stefanović, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit, tha se e ka lexuar këtë draft-memorandum të mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe komunitetit RAE, shihet

se kemi disa paqartësi, lidhur me disa gjëra për parcelën kadastrale ku do të ndërtohet objekti i banimit për këto komunitete në fshatin Prelluzhë. Prandaj kërkoj nga kuvendi mirëkuptimin që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, ashtu që ti marrim sqarimet e duhura. Ai njoftoi se në kontakt me kryetarin e komunës dhe me përfaqësuesin e organizatës jemi pajtuar që edhe një herë të shqyrtohet disa detale të kësaj çështje e më tej të vihet në kuvend për aprovim.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se ky investim përmes kësaj marrëveshje është i pari në qeverisjen Idrizi, duke përbërë një periudhë regresi nga qeveria e kaluar kur kishim investime të konsiderueshme në këtë drejtim duke bërë një zgjidhje për banorët që jetojnë në kushte jashtëzakonisht jo të përshtatshme të banimit. Pastaj shtoi se në mandatin kur ai ka shërbyer si drejtor, janë ndërtuar me donacione të ndryshme rreth 100 shtëpi për banoret me kushte jo të mira sociale. Ai pyeti se sa shtëpi janë ndërtuar gjatë qeverisjes së PDK-së për këto tri vite, sepse nuk kemi pasur fare investime. Megjithatë janë pro që të aprovohet kjo marrëveshje. Tutje ai vlerësoi se qeveria aktuale e komunës nuk ka vizon, për të bërë politika për zgjidhjen e çështjeve të banimit social, dhe kështu nuk ka as donacion, duke ceku se një rast i cili nuk ka të zgjidhur banimin ka mbetur pa u zgjidhur qysh nga fundi i mandati kur ai ishte pjesë e ekzekutivit, bëhet fjalë z.Rexhep Haradinaj, ku shtëpia e tij është përfshirë nga një fatkeqësi natyrore, dhe këtij akoma nuk i është bërë kurrfarë zgjidhje sepse i njëjti jeton me qira. Po ashtu përsërit se nuk janë kundër këtij projekti por ceku se shuma prej 240,000.00 € është një shumë e konsiderueshme andaj duhet të ketë një shfrytëzim racionale të këtyre mjeteve.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se edhe grupi kuvendar i LDK-së e përkrah këtë propozim, duke shtuar se duhet të sqarohet çështja e parcelës kadastrale.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se komuna po i jep 25 ari tokë dhe 80,000.00 € për ndërtimin e 5 shtëpive, dhe kjo nuk e di a ka shumë logjik, a ndoshta kishte me qenë më mirë të ndërtohet në atë tokë një ndërtesë kolektiv e banimit ku do të rehatoheshin 10 deri në 15 familje, dhe kjo do të ishte shumë më produktive, andaj propozon që kjo çështje dhe ky vendim të rishqyrtohet edhe një herë e më pas të silltet për kuvend për aprovim.

Violetë Thaqi, përfaqësuese e OJQ-së Zëri i Romëve, Ashklive dhe Egjiptasëve-paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Ajo kërkoj nga kuvendi që kjo pikë e rendit të ditës të aprovohet sot, sepse në të kundërtën rrezikojmë ta humbasim donatorin.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-vlerësoi se askush nuk është kundër që këto shtëpi të ndërtohen, sepse kjo është shumë mirë. Por e vërteta është se në këtë pikë kemi disa paqartësi, edhe për sa i përket shumave të mjeteve financiar që do të investohen. Po ashtu edhe informata për takim me banoret e fshatit Prelluzhë nuk kanë qenë të bollshme, andaj propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se me që ka rrezik që ky donacion të humbet është mirë që kjo pikë të votohet, sepse gjendja e atyre komuniteteve sa i përket banimit është tepër e rënd. Po ashtu mendon se zgjidhja më e mirë do të ishte që ndërtohej një objekt kolektiv banesor ku do të mund të sistemoheshin më shumë familje dhe do të bëhej zgjidhje afatgjate.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se kjo pikë e rendit të ditës duhet të votohet sot, sepse ka rrezik që të humbet ky donacion, po ashtu ai vlerësoi se kolegu nga komuniteti serbe ka tendencë që të pengohet ky projekt.

Spasoje Stefanoviç, anëtar i kuvendit-tha se askush nga komuniteti serb në Prelluzhë dhe as ai si anëtarë i kuvendit, nuk është kundër që të ndërtohen ato shtëpi për komunitetin RAI në fshatin Prelluzhë. Ajo se çfarë po mendon ai është që kjo çështje të qartësohet dhe të bëhet e mundur që

në kuadër të këtij memorandumi mirëkuptimi të ndërtohen sa më shumë shtëpi për komunitetin romë. Më qëllimi më të mirë që të bëhet e qartë kjo çështje si për parcelën kadastrale ashtu edhe për mënyrën e investimit kërkoj që kjo çështje të shtyhet deri në mbledhje e ardhshme.

Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 20 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Organizatës Joqeveritare “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve”.

2. Qëllimi i aprovimit të kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i bashkëpunimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” për riorganizimin dhe disegregimin etnik të vendbanimit në fshatin Prelluzhë, për të siguruar zgjidhje më afatgjatë të banimit të qëndrueshëm dhe mundësi për zhvillim socio-ekonomik për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

3. Ndër objektivat specifike të kësaj marrëveshjeje është zhvillimi i projektit për përmirësimin e kushteve të banimit social, duke zhvilluar projektin për ndërtimin e pesë (5) shtëpive për banorët e fshatit Prelluzhë të komunitetit RAE, në kuadër të fondit për bashkëfinancim mes Komunës së Vushtrrisë dhe OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve”.

4. Autorizohet kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të nënshkruajë këtë marrëveshje, duke i marrë përsipër obligimet që rrjedhin nga ky dokument.

5. Obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, që të bashkëpunojnë në mes vete për përmbushjen e obligimit për caktimin e lokacionit të ndërtimit të këtyre shtëpive, duke u bazuar në marrëveshjen e cekur si më lartë, konform legjislacionit në fuqi.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Draft-marrëveshja, kërkesa e parashtruar nga OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” dhe certifikata pronësore.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

8. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se ti jepet prona në shfrytëzim për 45 vite për 200 € për vit KEDS, është shumë tepër e papërfillshme dhe po ashtu e dëmshme. Ndërsa në anë tjetër një qytetar yni i cila ka hapur një kiosk në pronën e komunës, paguan të paktën 50 € në muaj qira

komunës. Kompania KEDS që është një kompani gjigande me miliona qarkullim ekonomik, ndërsa i paguan 200 € taksë komunës kjo është më tepër se qesharake. Prandaj ai bërë thirrje që mos të votohet ky propozim si ka ardhur, por të i caktohet një takës më e madhe për këtë kompani ashtu siç mendohet se është më e arsyeshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se ky propozim-vendim ka shumë të meta dhe nuk është i kompletuar sa duhet pasi që të njëjtit i mungon certifikatat pronësore dhe kopjet e planit, e po ashtu ka edhe gabime teknike në të shkruar. Tutje duke parë që KEDS është një kompani shumë profitabile, atëherë të njëjtës duhet ti vendoset një takës që është më lartë dhe që është reale.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-tha se ky propozim-vendim është dashur të vjen në kuvend më i kompletuar dhe seçifikisht të dihet se për cilën pronë po bëhet fjalë. Pastaj shtoj se në këtë rast çmimi nuk duhet marrë për bazë sepse është imediate të ndërtohet ajo trafo sepse ka defekte në ofrimin e shërbimeve të energjisë elektrike, dhe kjo trafo sigurisht se do ta përmirësonte dukshëm gjendje me furnizim me energji elektrike.

Nexhat Merovci, UD i drejtorit të drejtorisë së Urbanizmit-paraqiti sqarime specifike lidhur me këtë propozim-vendim, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarë e kuvendit. Ai vlerësoi dhe bëri të ditur se është imediate që të aprovohet ky vendim për faktin se është kërkesë e kahershme e komunitetit lokal që të vendoset trafo sepse ka pasur problem madhore me tension të ulët të energjisë elektrike.

Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 18 vota “për” 6 vota “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202021-000519-0, Zona Kadastrale Stanofc i Epërm, e cila përfshinë një sipërfaqe prej 14.84m² e marrë nga sipërfaqja e përgjithshme 3132.3m² pronë e Komunës së Vushtrrisë dhe prona e paluajtshme e Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në ngastrën kadastrale me nr.P-70202021-00575-0, Zona Kadastrale Stanofc i Epërm, e cila përfshinë sipërfaqe prej 16.85m² të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10053m², në shumën prej 200euro/copë.

2. Ngastrat kadastrale të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite KEDS-it për vendosjen e trafostacionit shpërndarës (blind) në sipërfaqe prej 4.00 X 3.00 m² dhe 4.00 X 4.00m².

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Pjese e këtij vendimi janë: certifikata e pronësisë, kopja e planit dhe skicat e projektit.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për përkrahje financiare për botimin e librit “Vushtrria në dokumentet osmane”

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim Prof. Ass. Dr. Mentor Hasani, Shef i Departamentit të Historisë në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës, i ofrohet përkrahje financiare në shumën prej nëntë mijë euro (9,000.00€) për realizimin e projektit studimor “Vushtrria në dokumentet osmane”, që për qëllim studimi ka historinë e Vushtrrisë gjatë periudhës osmane.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i komunës, kategoria subvencione dhe transfere, të drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe në drejtoritë ku ka mjete të lira.
3. Përfituesi i mjeteve financiare nga pika 1 e këtij vendimi duhet të dorëzojë në Komunë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa brenda 7 ditësh pas përfundimit të projektit raport kthyes për shfrytëzimin e subvencionit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
9. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.121/24 i datës 27.06.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Futbollit “Vushtrria”.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se edhe atë ditë, kur është votuar për këtë vendim kishte tërhequr vëmendjen se janë duke votuar kundërligjshëm, sepse përkrahja e klubeve dhe OJQ-ve, duhet të bëhet përmes thirrjes publike, por që me gjithat ishte votua ky vendim. Edhe përkund këtyre grupi i tyre nuk ka iniciuar ndonjë ankesë kundër këtij vendimi dhe këtë dëshiron ta bëjë të qartë për klubet që ta edhe përfaqësuesit e tyre ta dinë një gjë të tillë. Pastaj duhet bërë të qartë se askujt nuk mundsh ti ndihmohet duke e shkelur ligjin. Për subvencionimin e klubeve sportive rregullorja obligon që një vit më herët komuna ta ketë të aprovuar planin e ndihmës financiare për klubet dhe OJQ-të, të cila ka për synim ti subvencionoj dhe ndihmoj financiarisht. Prandaj si pasoj e paaftësisë dhe neglizhencës kemi vazhdimisht kthim të vendimeve si të kundërligjshme dhe ngjashme ka ndodhur me shumë vendime tjera sikurse vendimi për shujtat e punëtorëve të administratës komunale. Prandaj me këto veprime po tentohet të mashtrohet opinioni publik dhe mashtrim është bërë koncept i qeverisjes aktuale komunale.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se kryetari Ferit Idrizi, është një gënjeshtar, dhe se ai ka mashtruar dhe gënjyer, kur i ka sjellë në kuvend këto pika për aprovim, sepse paraprakisht e ka ditur se këto vendim nuk mund të zbatohen. Prandaj ne i kemi votuar atëherë këto vendim me qëllim që të mos etiketohemi se jemi kundër këtyre klubeve. Por e vërteta është se këto vendim janë të pa zbatueshme.

Pas debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimi me 11 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, kuvendi e rishqyrtoj vendimin me nr. protokollit nr.121/24 të datës 27.06.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Futbollit “Vushtrria”, të njëjtin nuk e shfuqizoj.

10. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.153/24 i datës 25.07.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Hendbollit KHF “Samadrexha”

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimi me 12 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, kuvendi e rishqyrtoj vendimin me nr. protokollit nr.153/24 i datës 25.07.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Hendbollit KHF “Samadrexha” të njëjtin nuk e shfuqizoj.

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për faljen e borxheve në taksat afariste për të gjitha bizneset nga 01.01.2000 deri 31.12.2017.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se falja e borxheve nga data 01.01.2000 deri më 31.12.2017, për gjithsej 1448 bizneseve afariste me shumë financiare prej afër 500,000.00 €, është gjë e dëmshme për Komunën e Vushtrrisë, por kjo po bëhet me qëllim sepse është vërejtje e auditorit të përgjithshëm. Qeverisja komunale e di mirë se këto borxhe nuk do të mund ti arkëtoj kurrë sepse në procedurë administrative këto borxhe janë parashkruar janë humbur. Por ajo çka do të duhej të ndalemi se për të gjitha këto dëme dikush do të duhej të japë përgjegjësi se përse nuk i ka ndërmarr veprimet e duhura sipas afateve ligjore për arkëtimin e këtyre borxheve që kanë pasur subjektet e ndryshme afariste ndaj Komunës së Vushtrrisë. Për më tepër kjo tregon se si ka funksionuar Drejtoria e Inspektimeve për gjatë gjithë këtyre viteve. Tani kuvendi për pos që është duke e falur këtë borxh është duke i amnistuar edhe zyrtarët komunal që kanë qenë të ngarkuar me detyra për ti mbledhur këto borxhe në formë të taksave komunale. Po ashtu nëse e shtrojmë çështjen ndryshe cili prej nesh do të kishte mundur ta marrë guximin që ti shkaktoj komunës dëme në vlerë prej 500 mi euro dhe të vinte lirisht në punë në komunë. Komuna dhe qeveria komunale do të duhet të ndërmarr masa ndaj atyre zyrtarëve që kanë ndërmarr veprime që i kanë shkakuar dëme të konsiderueshme komunës. Po ashtu qeveria komunale ka pasur për obligim që ti futë në listën e zezë të gjitha ato biznese që i kanë borxh Komunës së Vushtrrisë dhe të njëjtat nuk do të duhej kurrë të marrin tender në komunë dhe kurrfarë përfitimi tjetër nga Komuna e Vushtrrisë. Ajo çka është edhe më keq është fakti se ne kemi borxhe edhe aktualisht në vlera shumë të larta të cilat nuk jemi duke i arkëtuar, këtë e ka konstatuar edhe raporti i auditorit. Në këtë kontekst vlerësoi se kjo bëhet me qëllim sepse komuna i jep tokë me qira një subjektit afarist, më tej nuk ja kërkon borxhin i njëjti parashkruhet dhe dëmtohet komuna ndërsa zyrtaret e caktuar e ndaj fitimin së bashku me biznesin, ky mund të konsiderohet një cikël i krimit të organizuar.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-tha se para vetës kemi një pikë mjaft më rëndës të cilën do ta trajtojmë, fjala është për faljen e borxheve në vlerë prej 770,775.050 €, që konsideron se nuk është borxh real. Lidhur me këtë çështje ai kërkoj një mendim nga drejtoria i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe zyrtari profesionalë i Sekretarisë së Kuvendit, kjo për faktin se në vitin 2008 kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës kishte sjellë një vendim, me të cilin të gjithë qytetarëve të Kosovës iu ishin falë borxhet publike nga paslufta e deri më datën 31.12.2008. Ndërsa në këtë dokument të cilin e ka prezantuar drejtori, ky borxh është falur andaj nuk ka logjikë që dy institucione për të njëjtën çështje të marrin vendimin e njëjtë. Pra është dashur që ky vendi sot të ishte para nesh, dhe borxhet të falën vetëm nga data 01.01.2009 e tutje sepse borxhet e më hershme janë falur me vendim të qeverisë së Kosovës. Po ashtu vlerësoi se duhet shikuar edhe lëndët që janë pas viti 2017, sepse nëse ai borxh nuk është paguar deri në vitin 2024 atëherë i bie se edhe ky borxh është parashkruar sepse afati i parashkrimit në ligjin e marrëdhënieve të detyrimeve afati i

parashkrimit është 3 vite. Tek prona publike është situatë tjetër sepse kërkesat për borxhe nuk parashkruhen.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-tha se ky propozim-vendim duhet të përkrahet nga të gjithë pasi që, çështja e këtyre borxheve është edhe vërejtje e auditorit të përgjithshëm, dhe pavarësisht se kush është në qeverisje duhet që vërejtjet e auditorit të minimizojmë, ashtu që Komuna e Vushtrisë të dal sa më mirë në raportet e auditorit të përgjithshëm. Grupi kuvendar i LDK-së e përkrah këtë propozim-vendim.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me këtë propozim-vendim, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarë e kuvendit. Ai njoftoj se shumica e këtyre borxheve janë nga bizneset individuale, ku disa prej të cilave biznese edhe janë shuar, ndërsa borxhet aty figurojnë ende. Shumë komuna, kanë ndërmarr veprime dhe i kanë falur këto borxhe pasi që në shumicë ato janë të parashkruara. Lidhur me pyetjen e anëtarit të kuvendit z.Bekim Zabergja, sqaroi se kemi të bëjmë me një vendim të qeverisë së Kosovës, që bëhet fjalë për faljen e obligimeve nga tatimi në pronë, po ku përjashtohet taksa në firmë, për këtë çështje në atë kohë kishte marr edhe mendimin e zyrës ligjore në Qeverinë e Kosovës. Dhe kushti ka qenë që për tatimin e biznesi do të falet borxhi nëse për tri vitet e fundit firma arrin marrëveshje për kryerjen e obligimeve tatimore në të kundërtën borxh kthehet sërish, një gjë e tillë nuk ka vlejtur edhe për taksat biznesore.

Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 21 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet falja e borxhit të papaguar për taksën në aktivitete (afariste), për të gjithë taksapaguesit e Komunës së Vushtrisë nga data 01.01.2000 deri më 31.12.2017.
2. Me miratimin e këtij vendimi, do të shlyhen nga evidenca e borxheve të papaguara për taksën në aktivitete (afariste), të gjitha borxhet e taksapaguesve, përfitues nga periudha e cekur në pikën 1 të këtij vendimi nga zyrtarët përgjegjës të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 15:10

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A:	15.11.2024
REFERENCË:	10 Nr. 1139/24
PËR:	Antarët e KK-së
PËRMES:	z. Ferit Idrizi Kryetar i Komunës
NGA/:	Drejtori i DKA-së Albanez Tahiraj
TEMA:	Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2023-2024 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-068, për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 5, të Ligjit Nr.04/L-032, për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01.nr.209/2022, Drejtoria Komunale e Arsimit, paraqet këtë Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2023/2024 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025. Drejtoria Komunale e Arsimit objektivat e veta të planifikuara i ka realizuar në bashkërenditje të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI-Prishtinë), me Sektorin e Inspektoratit në Mitrovicë, si dhe me partnerë të jashtëm të arsimit.

Përmbajta:

Për punën e Drejtorisë së Arsimit.....	3
Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat.....	4
Investimet kapitale.....	8
Donacionet.....	10
Bursat dhe shpërblimet për nxënës.....	12
Garat, aktivitetet dhe të arriturat.....	13
Vlerësimet e jashtme	18
Aktivitetet për sigurinë në shkollat e Vushtrisë.....	21
Suksesi i gjysmëvjetorit të dytë 2023–24.....	22
Sfidat.....	26
Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024–2025.....	26

I. Për punën e Drejtorisë së Arsimit

Drejtoria Komunale e Arsimit e Vushtrisë ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor 2023–2024. Viti shkollor 2023–24 ka filluar më 1 shtator 2023, ndërsa gjysmëvjetori i parë ka përfunduar më 12 janar 2024. Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më 24 janar 2024, ndërsa ka përfunduar për klasat e 12-ta (maturantë) më datë 16.05.2024, për klasat 9, 10, 11, më datë 06.06.2024, ndërsa për klasat parafillore dhe 1–8 më 24.06.2024. Viti shkollor ka përfunduar më 31 gusht 2024.

Informata të përgjithshme:

- Numri i përgjithshëm i institucioneve edukativo-arsimore:
- 2 çerdhe dhe 1 paralele e ndarë fizike, e cila është në procedurë të pavarësimit;
- 3 shkolla fillore;
- 2 Shkolla të mesme të ulëta;
- 27 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta;
- 3 shkolla të mesme të larta;
- Numri i punonjësve: 1141;
- Numri i paraleleve: 651;

Numri i nxënësve:

- Niveli 0: (grup moshat 1–6 dhe çerdhet) i 148 fëmijë/nxënës;
- Niveli 1(klasa 1–5): 4882 nxënës;
- Niveli 2 (klasa 6–9): 4002 nxënës;
- Niveli 3 (klasa 10–12): 2265 nxënës;
- Gjithsej 12297 nxënës;

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023–2024, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë informatë. Këto zhvillime u bënë duke ndarë detyrat me kohë me qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

II. Zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, që objektiv kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regjional të Arsimit;
- Takime të rregullta me MASHTI-n;
- Takime të rregullta me KFOR-in sloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsim;
- Në protokollin e daljes janë regjistruar 626 shkresa;
- Në intranet janë regjistruar 337 dhe janë shqyrtuar 307;
- Në e-depo u regjistruan 56 hyrje dhe 56 dalje;
- Në të gjitha shkollat u shënuar dita e internetit të sigurt;
- Pjesëmarrje në konferencën përmbyllëse të projektit ARISE, zyrtarët e DKA-së kanë qenë pjesë e panelit për të folur në nivelin komunal për pabarazitë në arsim;
- U mbajt aktiviteti "Drejt Malit – HIKING" me nxënësit kampionë të garave komunale;
- Projekti KosEd "Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë (2021–2025)", i financuar nga BE-ja, në partneritet me MASHTI-n dhe Inspektoriatin e Arsimit e ka mbështetur vlerësimin e brendshëm të 5 shkollave në dy vitet e fundit bazuar në Modelin Kolegial Kosovar për sigurim të cilësisë. **Komuna e Vushtrrisë ishte komuna e parë** që filloi analizimin e të dhënave të prodhuara nga modeli kolegial për ndërtim të kapaciteteve dhe që t'i përdorë ato për të organizuar trajnime në të ardhmen. Raporti nga eksperti anglez Robert Blease;
- Është organizuar java e dyerve të hapura, ku nxënësit e klasave IX janë pritur nga shkollat profesionale. Të gjithë nxënësve iu është siguruar transporti;
- U mbajt ligjëratë për klasat X nga FSK-ja për pjesëmarrje në projektin "Edukimi për Siguri";
- U mbajt program artistik për nder të 7 marsit, Ditës së Mësuesit;
- Transporti i nxënësve është realizuar në 35 vija udhëtuese;
- Për 7 ditë nga data 10 shkurt deri më 24 shkurt 49 nxënës të SHFMU "Migjeni", Stanoc dhe SHFMU, Nedakoc, u përfshin në projektin "Drejt malit" në Brezovicë;
- SHFMU "Abdyl Frashëri", Druar, në kuadër të këtij projekti nga Kosed, shkolla ka realizuar edhe trajnime me bazë në shkollë, të cilat i kemi mbajtur dhe përfunduar me sukses dhe ku në fund mësimeve janë certifikuar.
- SHFMU "A. Z. Çajupi", Vushtrri, me nxënëset Olisa Krasniqi dhe Rihana Hyseni, së bashku me drejtorin e shkollës Visar Sadriu, kanë qenë pjesë e konferencës përmbyllëse të programit IPA FF, e cila është mbajtur në Bruksel. IPA FF shpërblen nxënëset dhe shkollën me mirënjohje për punën e bërë gjatë periudhës 3-mujore;
- SHFMU "Bahri Kuqi", Shtitaricë, ishte përfituese e një projekti nga "Transformimi Shoqëror Inovativ" të organizatës Dokufes dhe KEC, i quajtur KIST+. Ky projekt u financua nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, dhe shkolla ka përfituar shumë nga Klubi Medial. Gjatë aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të këtij projekti,

Klubi fitoi një shumë prej 180€. Më pas, nga organizata mbështetëse OJQ Shoqata Kulturore “Gjurmët”, shkolla ka marrë një tjetër ndihmë në vlerë prej 500€, të cilat janë shfrytëzuar për realizimin e nevojave të projektit.

- Në SHFMU në Pestovë u mbajt një trajnim nga Qendra Psiko-Sociale për Traumatëri – Diakonie Kosova;
- Në SHFMU në Pestovë, Zyra Qëndrore të IAP-së në Prishtinë, Departamenti për të Drejtat e Fëmijëve ka organizuar Fushatë Informuese "Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit";
- Bashkëpunimi me delegacionin turk nga INSTITUTI YNUS EMRA, ku shpalosen planin e tyre dhe mbështetjen e plotë financiare për nxënësit të cilët dëshirojnë t'i ndjekin mësimet në shkollimin e mesëm në Turqi;
- Bashkëpunimi me OSBE-në me temë: “Hartimi i Planit të Veprimit të Mekanizmit Koordinues kundër dhunës në familje” – Vizioni dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë;
- Pjesëmarrje në Forumin III të OZHQ-ve të organizuar nga INDEP në bashkëpunim me Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm, ku u diskutuan zotimet e marra nga ana e Qeverisë në përmbushjen IV zotimeve në mbledhjen e fundit të Kombeve të Bashkuara, të cilat duhet të përmbushen deri në vitin 2030;
- Këshilltarët nga zyra e kryeministrit znj. Elizabeta Gowing, znj. Merita Januzi nga MASHTI dhe z. Habit Hajredini përfaqësues i zyrës së mirë (të gjithë nga NIVELI QENDROR). Vizituan ekipin e DKA-së kundër braktisje dhe SHMU-2 si shëmbull i mirë i punës kundër braktisjes;
- Në SHFMU “Liria”, Stroc, grupi letrar “Zëri ynë” ka zhvilluar takime letrare me anëtarët e Karvanit të Shkrimtarëve për Fëmijë: Xhevat Sylja, Ibrahim Kadriu, Prend Buzhala, Xhemë Karadaku, Erina Rrahmani, Jonuz Fetahaj, Gjon Gjergjaj, Ismet Krasniqi, Fazli Ferati dhe Idriz Berisha;
- Drejtoria Komunale e Arsimit bashkë me SHMU-1 dhe psikologë të shkollave shënoi 1 qershorin, “Ditën e fëmijëve”;
- Në SHMLP “Bahri Haxha”, Vushtrri, është nënshkruar marrëveshja me të cilën SHMLP “Bahri Haxha” do të jetë pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin CultiVeting ndër shkollat e para publike e përfshirë në këtë program (gjatë muajit qershor është realizuar vizita e pare studimore në Athinë);
- Marrëveshje bashkëpunim, Drejtoria për Arsim ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me OJQ Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile “Koralet”, ku do të vazhdohet financimi i tri edukatoreve në tri qendra me bazë në komunitet. Ky bashkëpunim realizohet në tri shkolla, e që janë SHFMU “Migjeni” në Stanoc të Epërm, SHFMU “Nazmi Zhegrova” në Stanoc të Poshtëm dhe në SHFMU “Hajrullah Shala” në Akrashticë;
- Marrëveshje Bashkëpunimi mes të QEHT – KONICA dhe DKA-së së Vushtrrisë, ku janë trajnuar 25 mësimdhënës nga cikli i ulët, 25 mësimdhënës nga cikli i mesëm i ulët me trajnimin: "Planifikimi i mësimdhënies produktive", "Metodologji interaktive e mësimdhënies";
- Marrëveshje bashkëpunimi mes DKA-së në Vushtrri dhe SHPIK-ut (Shoqata Profesionale e informaticentëve të Kosovës për trajnimin e gjithë mësimdhënësve për kodim);
- Iniciativa për Barazi Gjinore në SHFMU “A. Z. Çajupi” nga Teach For Kosova, ka themeluar klubin për barazi gjinore të përbërë nga 20 nxënës;

- Drejtoria e Arsimit, gjatë kësaj periudhe ka miratuar Planin e Veprimit për Sigurinë e Shkollave 2023–2026;
- U mbajt tryezë diskutimi me prindër mbi temën: Efektet negative të drogës në Gjimnazin “Eqrem Çabej” në Vushtri;
- Drejtoria Komunale e Arsimit ka organizuar pyetësor për dhunën në shkolla, si dhe ka analizuar pyetësorin, dhe në bazë të kësaj analize i cakton ligjëratat vetëdijësuese nëpër shkolla;
- U organizua tryezë diskutimi për të shënuar 19 Nëntorin – Ditën botërore të parandalimit të abuzimit ndaj fëmijëve;
- U përruan parqet në SHMLP “Bahri Haxha” dhe në Gjimnazin “Eqrem Çabej” në Vushtri, projekt i financuar nga CARITAS-i zviceran – Ndikimi i Rinisë në Mjedis (YENI), dhe CEDE, projekti ka kushtuar 8800 euro, ndërsa komuna ka participuar me 800 euro;
- U shënuar themelimi i 60-vjetorit të gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtri;
- U shpërblyen 5 shkolla të Vushtrrisë të cilat më së miri i kanë futur të dhënat në SMIA (për dhunën e fëmijëve në shkolla); SHMU-1, SHMU-2, SHFMU “A. Z. Çajupi” Vushtri, SHFMU “Latif Berisha”, Doberllukë, dhe SHFMU “Liria”, Stroc;
- Në SHMLP “Bahri Haxha” janë nënshkruar marrëveshjet për realizimin e “Mësimi dual” me Interex dhe Viva fresh për nxënësit e profilit “Tregtarë me pakicë dhe shumicë;
- Në SHMLP “Bahri Haxha” ka vazhduar projekti mësimi në vendin e punës mbështetur nga GFA/GIZ dhe 170 nxënës të klasave XI dhe XII janë duke kryer praktikën në vendin e punës.
- SHMP “Bahri Haxha” do të jetë pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin Cultiveting.
- SHFMU “Bahri Kuqi” në Shtitaricë është përfituese e një projekti KIST+ e mbështetur nga Organizata e Mbretërisë së bashkuar të Holandës në mesin e 12 shkollave në nivel vendi për Edukim Medial;
- Në SHFMU “A. Z. Çajupi” Organizata “Teach For Kosova” ka organizuar punëtori 4-ditore me 10 mësimdhënës të shkollës. Qëllimi i punëtorisë është krijimi i një katalogu për edukim inkulziv, ka përmbajtur aktivitete që kontribuojnë në gjithëpërfshirjen në klasa dhe do t’u shërbejë të gjithë mësimdhënësve, si dhe ka realizuar projektin 1-vjeçar “Let Girls Thrive”, që ka të bëjë me barazi dhe drejtësi sociale;
- Marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet DKA-së (Drejtorisë Komunale për Arsim, Komuna e Vushtrrisë) dhe FXHK-së (Federatës së Xhudos së Kosovës me programin “Kosova, Shtet i Xhudos) me shkollën SHMU-1 dhe SHMU-2;
- Në SHMLP “Bahri Haxha”, Vushtri, ka vazhduar projekti mësimi në vendin e punës mbështetur nga GFA/GIZ dhe 170 nxënës të klasave XI dhe XII kanë kryer praktikën në vendin e punës;
- Në SHMLP “Bahri Haxha” është pilotuar “Mësimi dual” për 27 nxënësit e profilit “Tregtarë me pakicë dhe shumicë” (ka pasur vështësi për shkak të mosgatishmërisë së bizneseve për të përmbushur kontratat me nxënës ku parashihet edhe pagesa

mujore);

Janë pajisur me pajisje bashkëkohore për realizimin e praktikës profesionale kabinetet e kimisë, teknologjise ushqimore dhe agrobiznesit (planifikim me buxhetin e shkollës);

- Në SHMLP “Bahri Haxha” 22 nxënës janë trajnuar dhe certifikuar në trajnimin “Zhvillimi i aftësive kreative për film dhe Animacion” tek të rinjtë” nga Instituti për zhvillim dhe integrim;
- Në SHMLP “Bahri Haxha” kanë filluar përgatitjet për nënshkrimin e marrëveshjes për financim për grantin e fituar nga RCF (fondi rajonal i sfidave, i cili financohet nga Qeveria Gjermane dhe Zvicrane) në vlerën 410.000 euro;
- SHML “Bahri Haxha” është përzgjedhur nga MZHE për digjitalizimin e procesit mësimor (do të kryhet gjatë muajit korrik);
- Pjesëmarrja në projektin “Ndikimi i rinisë në mjedis” YENI I CARITASIT - “Ndërgjegjësimi ndaj ndryshimeve klimatike”.

III. Investimet kapitale:

Gjysmëvjeteri i parë 2023–2024

- Renovimi i çerdhes 1;
- Renovimi i çerdhes 2;
- Ndërtimi i deposë për çerdhen III;
- Ndërtimi i deposë për çerdhen II;
- Renovimi i SHFMU "Migjeni", Stanoc, lagjja Cakaj;
- Renovimi i SHFMU "Lumni Surdulli", Samadrexhë;
- Renovimi i SHFMU "Enver Hadri", Smrekonicë;
- Ndërtimi i platosë për SHFMU "Emin Duraku", Novolan;
- Ndërtimi i deposë në SHFMU "Adem Voca", Pasomë;
- Ndërtimi i deposë për SHFMU "Migjeni", lagjja Cakaj;
- Ndërtimi i deposë për SHFMU "Migjeni", Stanoc;
- Ndërtimi i deposë për SHFMU "Enver Hadri", Smrekonicë;
- Ndërtimi i deposë për SHF "Ali Kelmendi", Vushtrri;
- Ndërtimi i deposë për SHF "Ali Kelmendi", Vushtrri;
- Ndërtimi i deposë për SHFMU "7 Marsi", Bukosh;
- Ndërtimi i deposë për SHFMU "Avdyl Frashëri", Druar;
- Rrethoja dhe muri mbrojtës SHFMU "Bajram Curri", Dumnice;
- Fillimi i ndërtimit të objektit shtesë në SHFMU "Mustafë Venhari", Vushtrri;
- Renovimi i SHFMU "Latif Berisha", Doberllukë;
- Renovimi i SHFMU "Liria", Stroc – Gllavotin;
- Renovimi i SHFMU "Martirët", Reznik;
- Renovimi i SHFMU "12 qershori", Mihaliq;
- Renovimi i SHFMU "Rilindja", Maxhunaj;
- Renovimi i SHF "Ali Kelmendi", Vushtrri;
- Renovimi i SHFMU, Lummadh;
- Renovimi i SHFMU "Adem Voca", Pasomë;
- Ndërtimi i platosë për SHFMU "28 Nëntori", Vërnice;
- Ndërtimi i deposë për SHFMU "Martirët", Reznik;
- Pajisje për praktikë profesionale SHMLP "Bahri Haxha", Vushtrri;
- Meremetimi i Gjimnazit "Eqrem Çabej", Vushtrri;

- Meremetimi i SHMLT "Lutfi Musiqi", Vushtrri;
- Teknologji informative SHMLT "Lutfi Musiqi", Vushtrri;
- Teknologji informative Gjinnazi "Eqrem Çabej", Vushtrri
- Teknologji informative SHMLP "Bahri Haxha", Vushtrri
- Blerja e pajisjeve të TI (televizor) "Bahri Haxha", Vushtrri;
- Ndërtimi i tualeteve në SHMU "Emin Duraku", Novolan;
- Pajisje për praktikë profesionale SHMLP "Bahri Haxha", Vushtrri;
- Meremetimi i SHFMU "Rexhep MUSA", Ceceli;
- Renovimi i SHF "ALI KELMENDI", Vushtrri;
- Renovimi i SHFMU, LUMMAËH;
- Renovimi i SHFMU "LUMNI SURDULLI", Samadrexhë;
- Renovimi i SHFMU "RILINDJA", Maxhunaj;
- Renovimi i SHFMU "HAJRULLAH SHALA", Akrashticë;

Gjysmëvjetori i parë 2023–2024 deri në fundin e vitit shkollor 2023–2024

- Në Gjinnaz: rregullimi i dyerve të tualeteve të shkollës;
- Në Gjinnaz: mbjellja e luleve në oborrin e shkollës;
- Në SHFMU "MiGJENI", Stanoc i Epërm, është rregulluar kanalizimi në objektin e shkollës dhe jashtë saj deri në lidhjen e kanalizimi të fshatit;
- U rrënuar shkolla e vjetër në SHFMU, Pestovë;
- Në SHMU-1 u shtrua zhavor për parkingun e veturave;
- Demolimi i objektit të vjetër në SHMU-1;

IV. Donacionet

- Gjumnazi “Eqrem Çabej” ka pranuar donacione nga “NB CONSTRUCTION” në Vushtrri me pronar z. Kujtim Pllana, me vlerë 500 euro, pajisje sportive nga kompania Deloitt - Vushtrri, rregullimi i ulëseve në oborrin e shkollës dhe mbjelljen e luleve, si dhe nga Prof. Raif Mehmeti ish-mësimdhënës i Gjumnazit, përkatësisht nga shoqata Nyrbo-FN-Forening me v. printari në Suedi, me vlerë 300 euro për tre nxënës;
- SHFMU “12 Qershori” në Mihaliq ka pranuar donacione nga Avni Sylja, banor i fshatit, i cili ka bërë një investim në ndërrimin e dritave në të gjithë hapësirën shkollë, dritat emergjente, ndërprerës në klasën e 9-të, reflektorë në hapësirën e jashtme shkollë, kabllon për përcjelljen e rrymës në shkollë, topa futbollit, volejbollit dhe basketbollit, si dhe ka dhuruar një kosh për basketboll;
- SHFMU “Lumni Surdulli” në Samadrexhë ka pranuar donacione nga Këshilli i Fshatit Samadrexhë, ku kanë dhuruar shkollës një zërim dhe disa veshje kombëtare për nxënës;
- SHFMU “Bahri Kuqi” ka pranuar donacione nga Lulishtja Liridoni, i cili ka sjellë fidanë dhe drunj dekorativë për shkollë. Donacioni tjetër i radhës ka qenë nga kompania Venta, e cili ka dhuruar 100€ euro për të blerë pajisje sportive. Nga kompania AMIS ka pranuar një donacion me ndërresa sportive për klubin e futbollit dhe të volejbollit. Ndërsa libra kanë dhuruar: Ferdane Pllana Zabërgja, Ibrahim Kuqi, Remzije Zekolli dhe Bedri Tahiri. Nga ky i fundit ka pranuar mbi 100 kopje librash të ndryshëm të botuara dhe të krijuara nga vetë autori;
- SHMU 1 ka pranuar këto donacione:
 1. Rafta për libra. Donacion nga prindërit në vlerë 300 euro;
 2. Kamera 5 sosh, vlera e tyre kap shifren 450 euro, Beni Shop dhe prindërit;
 4. Libra për Bibliotekën e shkollës zinj. Ilmije (Jonuzi) Feka, vlera 250 euro;
 5. Kompania Gjoni material për mirëmbajtje, vlera 90 euro;
 6. Çezme betoni dekoruese për oborr nga kompania Filizi, vlera 150 Euro, pajisje për ujin Bekim Vershevcu 40 euro 15.06.2023;
 7. Zile elektrike automatike-digitale Alban Maloku, vlera 60 euro;
 8. Qendra Rinore Hareja, ngjyra, brusha, pëlhura për pikturim, vlera 250 euro;
 9. Printer për klasa dhe dollapa, prindërit, vlera 200 euro. Data: 25.03.2024;
 10. Benny Shop TV Smart me pajisje përcjellëse, vlera 300 euro, Data: 23.03.2024;
 11. Ariani Comani beton për rregullimin e rrethojës së fushës sportive, vlera 140 euro;
 12. Rregullimi i Bibliotekës, vlera 900 euro – 19.06.2024 donacion nga drejtori i shkollës;
- SHFMU “Liria”, Stroc: Forumi për Integrim Social – FIS në bashkëpunim me zyrën e Presidencës së Kosovës – Donacion: ngjyra, pëlhura, brusha për ekspozitë, vlera 200.00 euro
- Kompania “Rida Com” me pronar Naser Zymberi ka rregulluar pjesët e mbetura për gjelbërim brenda oborrit të shkollës në SHFMU “Emin Duraku” Novolan;
- SHFMU “Andon Zako Çajupi” & Interex, Union-SHPK dhe SHPK - Camel - Në kuadër të festave të fund vitit kanë shpërndarë dhurata për të gjithë nxënësit e nivelit 1 (klasa 1-5);

- SHFMU “Gj. K. Skënderbeu” në Pantinë ka pranuar donacion nga IPKO: 4 TV Fuego 55", 1 Printer laser MFP 135a, 1 Laptop Acer, 4 Mbajtës TV, 4 Kabllo HDMI (5m), 1 USB, Donacioni nga Aztech", 1 Tv Toshiba 58", Donacion nga Extra Color, ngjyrë e bardhe 25l.
- SHFMU “Enver Hadri” në Smrekonicë ka pranuar donacion: 11 kompjuterë për nxënës (nga firma zvicerane FON FCM LLC me menaxher Rafet Mehmeti), klimë për parafillorët dhe tepison. Donacion nga KFOR-i Slloven për parafillorët: Një televizor, një tepih puzzle, lodra për fëmijë dhe mjete pune konkretizimi
- SHFMU “Abdyl Frashëri” në Druar ka përfituar një kosh për basket nga USAID-i;
- SHFMU “Liria” në Stroc ka pranuar Smart Bord – Tabelë e mençur nga organizata gjermane GIZ;
- SHF “Mustafë Venhari”, Vushtrri: Fadil Saraçi dhuroi 1500 euro, ndërsa një prind deshi të mbesë anonim, dhuroi 200 euro;
- SHFMU “Migjeni”, Stanoc i Epërm: Ordinanca Drita-Stanoc i Epërm dr. Nystret Haradinaj, dhuron libra për nxënësit e klasës së dytë dhe pajisje shkollore. Gjatë muajit tetor mobileria Eli Decor, Stanoc i Ep., me pronar Hajrush Shala pajisi klasat në lagjen Cakaj me dollapa për nxënës dhe tabela për vendosjen e punimeve të nxënësve. OJQ ACCESS bëri dekorimin e shkollëve të shkollës dhe krijoi një ambient shumëngjyrësh dhe motivues.
- Prindërit e shkollës në Pestovë ngjyrosen vijat e fushave dhe rregullimin e tabelës së basketbollit. Tavolinën e Pingpongut, si dhe pajisen me dollapa për një klasë;

V. Bursat dhe shpërblimet për nxënës

Informata të përgjithshme për bursa:

- **Numri i bursave brenda vendit – 70 (shtatëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një studentë/e për studime brenda vendit.
- **Numri i bursave jashtë vendit - 17 (shtatëmbëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;
- Vlera e bursës – 1000.00 € (një mijë) për student/e për vendet e BE-së;
- Përfitues të bursave sipas gjinisë: 59 janë studente dhe 28 janë studentë;
- Gjithsej përfitues të bursës 87 studentë, me vlerë 56.600.00 euro;
- Ndërsa DKA në Vushtrri, deri tash gjatë këtij viti ka subvencionuar 12 studentë, të cilët i kanë kushtet e rënda ekonomike ose kanë vetëm njërin prind, ose prindërit invalidë, me vlerë 4100 euro;
- Studentë në Greqi – në York City Colege janë 4 studentë, 2 baçelor dhe 2 master janë subvencionuar me 24.630 euro.
- **Gjithsej përfitues 103 studentë më vlerë 85.330.00 euro.**

Shpërblimet e nxënësve;

- Më datë 21.06.2024 DKA ka propozuar shpërblimet për nxënës pikërisht në fundin e gjysmëvjetorit të dytë, ndërsa më datë 24.06.2024, Kryetari i Komunës ka nxjerrë vendim për t'i shpërblyer nxënësit/et;
- Për vendet e para: 42 nxënës/e me vlerë 4350€;
- Për vendet e dyta: 18 nxënës/e me vlerë 1475€;
- Për vendet e treta: 13 nxënës/e me vlerë 650€;
- Tri vende të para për 8 nxënës/e 600 €;
- Gjithsej përfitues 81 nxënës/e;
- 3 nxënës të gjimnazit janë financuar për udhëtime jashtë vendit me vlerë 2500 € Tauna Grabovci dhe Suela Selimi, nxënësë të Gjimnazit “Eqrem Çabej”, të cilat do të shkojnë për hulumtime shkencore në fizikë në Universitetin Santakruz – Kaliforni dhe 1 nxënës, Eriti Rushiti, pjesëmarrës në gara republikane botërore të fizikës, e cila do të mbahet në Iran);
- 2 nxënës, Lorik Rama nx. i Gjimnazit “Eqrem Çabej” marrin pjesë në Olimpiadë STEM në Hagë të Holandë, dhe Jonart Krasniqi nga SHF “Ali Kelmendi” u jepet ndihmë financiare 1800 €;
- Përmbledhje: Gjithsej janë në proces të shpërblimeve 92 nxënës në vlerë 18275€

VI. Garat, aktivitetet dhe të arriturat

- Eko-klubi i SHMLP “Bahri Haxha” ka fituar çmimin e parë mjedisor “Dervish Rozhaja” në vlerën prej 10.000 euro në garën me projekte mjedisore të mbajtur në fillim të muajit Qershor;
- Në garat e shahut organizuar nga Innovation Academy dhe Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Vushtrri, nxënësi i klasës IV nga SHFMU - Pestova, Ensar Salihu, ka zënë vendin e parë në këtë garë;
- “Mozaiku Kulturor i Vushtrrisë në Pikturë” është titulluar ekspozita e artit që është organizuar nga Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me OJQ “ORDA”. Në këtë garë individuale morën pjesë gjithsej 15 nxënës/e, ndërsa u shpërblyen tre prej tyre. Vendi i parë: SHMU 1, Vushtrri, me nxënësen Yllka Podvorica, e cila u shpërblye me 100 euro;
- Në garat republikane të programit "SPORTI NË SHKOLLA" NË BASKETBOLL 3x3 në Sheshin Skënderbeu, Prishtinë, u zhvilluan Garat Republikane të Programit "Sport në Shkolla", me pjesëmarrjen e 28 ekipeve të klasave 6–9 vajza dhe djem nga 14 shkolla të 7 regjioneve. SHMU 1 ka zënë vendin e parë nga klasat VI dhe VII (Meshkujt);
- Në garën për esenë më të mirë të mbajtur në shkollën "Mehmet Akif", nxënësja e SHFMU “Liria” në Stroc, Rrezartë Aliu, ka zënë vendin e tretë.

Vendet e para:

1. **Edison Muhamet Haliti**, nxënës i klasës XII nga Gjimnazi “Eqrem Çabej” në Vushtrri, zuri vendin e parë në garat e diturisë, lënda e Biologjisë. Ai u shpërblye me 100 €; si dhe vendi i tretë në garat e diturisë, lënda e Kimisë, është shpërblyer me 50 €, gjithsej **150 €**.
2. **Rizonë Gani Hyseni**, nxënës e klasës XII e Gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtrri, vendi i parë në garat e diturisë, lënda Kimi, është shpërblyer me 100 € dhe vendi i tretë në garat e diturisë, lënda Biologji, është shpërblyer me 50€, gjithsej **150 €**;
3. **Erion Blerim Hyseni**, nxënës i klasës XI i Gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtrri, vendi i parë në nivel Republikan me projektin Laviersi Matematik Digjital), është shpërblyer me 100€;
4. **Abit Ilmi Hyseni**, nxënës i Gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtrri, vendi i parë në nivel Republikan me projektin Laviersi Matematik Digjital), është shpërblyer me 100 €;
Ndërsa në bazë të të dhënave te siguruar nga ATK – zyra regjionale ne Mitrovice, gjithsej numri i të punësuarëve në komunën tonë – sektorin privat është;

- **Të punësuar – dallon sipas muajve por qe mesatarja e te punesuarëve është 4569**

Objektivat e sektorit për zhvillim ekonomik – biznes janë:

- afrimi i shërbimeve të avancuara për biznese
- zvogëlimi i numrit të bizneseve pasive
- bashkëpunimi më i ngushtë me biznese e sidomos me ato prodhuese të cilat mund të gjenerojnë vende të reja te punës.
- vizitat me të shpeshta nëpër biznese me qëllim që të njihen me mundësit e zgjerimit të bizneseve të tyre
- Drejtoria për Ekonomi është e hapur çdo here për bashkëpunim me shoqatat e ndryshme afariste por edhe për çfardo kërkesë që vjen nga ato.
- themelimi dhe bashkëpunimi dhe më i ngushtë me shoqatës afariste dhe Drejtorisë për Ekonomi.
- Përkrahja më e madhe e bizneseve bujqësore etj.
- Përkrahje e bizneseve te grave
- Bizneset fillestare
- Organizimi i panairove

Bizneset e Shuara

1	811110626	B.Individual	Gjergj Fishta	D	B.I	hoteleri	03.01.24
2	810690950	Salloni Ondulimi TEUTA	Vushtri	D	B.I	ndertimtari	02.02.24
3	812000272	B.Individual	Bulevardi Adem Jashari	D	B.I	tregti	08.02.24
4	811108019	B.Individual	Vushtri	D	B.I	treg. karburanteve	09.02.24
5	811923110	Le Reina Dresses	Faruk Beqiri	D	SHPK	tekstil	15.02.24
6	811370593	Ademi Color sh.p.k	Vushtri	D	SHPK	suvatim	26.02.24
7	812043488	B.Individual	Mic Sokoli	D	B.I	ekspert i vler.te dameve	26.02.24
8	811109893	B.Individual	D.e Kombit	D	B.I	agjension turistik	27.02.24
9	812044957	Dardan M. Rexha	rr.Gjon Buzuku ,pn	D	B.I	callcenter	04.03.24
10	810684284	B.Individual	14,qameris bill III	D	B.I	restorant	21.03.24
11	811113539	B.Individual	Azem Bejta,nr42	D	B.I	transport i mallrave	25.03.24
12	811117888	B.Individual	Arsim Muzaqi	D	B.I	ushqim me porosi	25.03.24
13	812048610	B.Individual	Stanoc I poshtem	D	B.I	perpunim metalik	26.03.24
14	812105478	B.Individual	Gjergj Kastrioti Skenderbeu	D	B.I	furre buke	02.04.24
15	810067381	MX Group	D. e Kombit	D	SHPK	treg.me shumic pjjev	02.04.24
16	811349605	Ari Pharm SH.P.K	Tirana nr.76	D	SHPK	barnatore	03.04.24
17	810693780	B.Individual	2 Maji nr.59	D	B.I	treg.ushqimore	05.04.24
18	810686446	B.Individual	Ganimete Tërbeshi	D	B.I	tregtia me pakice	19.04.24
19	810694093	B.Individual	Bedri Pejani	D	B.I	qiradhenes	23.04.24
20	812041200	ZIA SH.P.K	Gjergj Fishta	D	SHPK	frizer	24.04.24
21	811550898	HANA GROUP SH.P.K	Vesil Klark	D	SHPK	ndermjetsues I shitjes	29.05.24
22	810683187	B.Individual	Isë Mernica	D	B.I	tregtia ushqimore	31.05.24
23	811107160	SKAB GROUP SH.P.K	Gjergj Kastrioti Skenderbeu	D	SHPK	prodh.i prod.plastike	04.06.24
24	810688377	B.Individual	Gjergj Kastrioti Skenderbeu	D	B.I	autoshkolle	07.06.24
25	811370452	B.Individual	Doberllukë	D	B.I	mirembajt.automjet	11.06.24
26	812093764	B.Individual	Dëshmorët e Kombit	D	B.I	restorant	12.06.24
27	811955329	Furrë Buke ANDI SH.P.K	Magjst. Vushtri-Mitrovicë	D	SHPK	furre buke	02.07.24
28	810692427	B.Individual	Adem Jashari	D	B.I	frizere	16.07.24
29	811323378	B.Individual	Faruk Beqiri	D	B.I	tregtia me pakice	30.07.24
30	812168997	B.Individual	Sabri Ferati nr.7	D	B.I	taxi	30.07.24
31	810691643	B.Individual	Rashit Deda	D	B.I	mirembajt.automjet	01.08.24
32	811870949	Diamanti Cleaning SH.P.K	Mihaliq	D	SHPK	kompani pastrimi	02.08.24
33	811119438	B.Individual	Duboc	D	B.I	fermë e perzier	12.08.24

34	811968992	BLISS HOME SH.P.K	Stanoc I poshtem	D	SHPK	prodhim I mobileve	12.08.24
35	811516379	B.Individual	Dëshmoret e Kombit	D	B.I	tekstil	12.08.24
36	811108473	B.Individual	Dëshmoret e Kombit	D	B.I	frizer	12.08.24
37	811117797	B.Individual	Nazmi Popova Hyzeni	D	B.I	programer	12.08.24
38	810691601	B.Individual	Dëshmoret e Kombit	D	B.I	play station	26.08.24
39	811850248	B.Individual	Basri Beqiri	D	B.I	mjek	10.09.24
40	512174415	B.Individual	Maxhunaj	D	B.I	kompani pastrimi	25.09.24
41	810683715	B.Individual	Sheshi I Lirise	D	B.I	aktivitete tw ushqimit	30.09.24
42	810684549	B.Individual	Dëshmoret e Kombit	D	B.I	qebaptoe	02.10.24
43	811110072	B.Individual	Samadrexhe	D	B.I	taxi	03.10.24
44	812007088	Osmani Group SH.P.K	Vëllezërit Gërvalla	D	SHPK	nderimtari	07.10.24
45	810158966	B.Individual	Resnik	D	B.I	fermë	21.10.24
46	812191253	B.Individual	Jeton Tërstena	D	B.I	programer	21.10.24
47	812191245	B.Individual	Ukshin Kovaqica	D	B.I	mirembajt.automjet	21.10.24
48	811117127	B.Individual	Maxhunaj	D	B.I	instalime elektrike	21.10.24
49	812073295	B.Individual	Bahri Kuqi	D	B.I	rrobagespse	25.10.24
50	811955915	Maxx LSHB Construction S	Dëshmoret e Kombit	D	SHPK	nderimtari	25.10.24
51	810683682	B.Individual	Vëllezërit Gërvalla	D	B.I	tregtia me pakice	28.10.24



Republika e Kosovës
Republika Kosova • Republic of Kosova



Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn • Municipality of Vushtrri

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

DATË/A	07.11.2024
REFERENC-Ë:	08Nr.464
PËR/ZA/TO:	Kryesuesën e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë Znj. Melihate Basholli-Latifi, Anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa, Anëtarët e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z.Ferit Idrizi
NGA/OD/FROM:	Drejtori i drejtorisë Drilon Jusufi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit Komunal e cila ka të bëjë me Informatën lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal e cila përfshinë periudhën nga Janari i këtij viti, DUMM ju informon se sa i përket Planit Zhvillimor Komunal i aprovuar me vendim nr.01Nr.126/17 të dt.04.05.2017 nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë për periudhën 2016-2024, i cili është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku tetë (8) vjeçare.

Gjatë periudhës Janar – Nëntor 2024, lidhur me zbatimin e objektivave të parashikuara në planin e lartcekur kryesisht janë mbajtur takimet e organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, takimet e rregullta me komunitetet e zonave të ndryshme, propozimet e ndryshme për rregullim, takimet e rregullta me nivelin qendror si dhe rritja e bashkëpunimit në mes të DUMM me drejtoritë tjera për qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta si dhe në muajin dhjetor të vitit paraprak kemi hartuar propozim-vendimin për iniciimin e procedurave për Hartimin e PZHK-së pasi që e njeta në vitin 2024 i skadon afati , dhe i njeti është aprovuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë.

Dhe pas aprovimit të këtij vendimi me nr.protok.01Nr.287/23 të datës:28.12.2023 Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor me nr.04/L-174 si dhe akteve tjera nënligjore që rregullojnë fushën e ndërtimit dhe planifikimit ka bërë kërkesë në Drejtorinë për Prokurim për të iniciuar procedurat e përzgjedhejs së një kompanie konsulente e cila do të na ndihmonte të hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032,



ku tani kjo procedurë është përfunduar dhe është lidhur Kontrata me kompanin konsulente Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë Insi sh.p.k. me seli në Prishtinë, si Operator Ekonomik, të cilën e përfaqëson z. Ismajl Baftiari, në tekstin e mëtejme KONTRAKTUESI — KRYESI 1 SHËRBIMIT, dhe Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : Ilmi Azemi — Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik.

Kryetari i komunës z.Ferit IDRIZI me vendim ka caktuar grupin punues i cili menjëherë ka filluar takimet për mbledhjen e të dhënave dhe në bashkpunim dhe konsultim me kompanin konsulente tani jemi në fazën e hartimit të draftit të parë të PZHK-së 2024-2032 ku për fillim do të bëhet hartimi I vizionit dhe qëllimi i këtij plani.

Ndërsa sa i përket zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024 DUMM në çdo kërkesë të pranuar nga zyrtaret përgjegjës gjatë shqyrtimit të tyre që kanë të bëjnë me ndërtime dhe informime tjera rreth destinimit të parcelave kadastrale, janë udhëzuar me destinimin e përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal po ashtu kërkesat e parashtruara për marrjen e Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore dhe Lejeve për Rrënimin e objekteve për kategorinë e parë (I) dhe të dytë (II) janë trajtuar me përkushtim të lartë dhe në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2016-2024.

Me respekt!







REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Shërbime Publike

Datë/a:	12.11.2024
Për:	KPF, Kuvendin Komunal
Përmes:	Kryetari i Komunës Ferit Idrizi 
Nga:	Drejtori i Drejtorisë Benjamin Shala 
Tema:	Informatë për menaxhimin e mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë

Të nderuar anëtar të komitetit për politikë dhe financa, anëtar të kuvendit,

Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale. Pra ky ligj ka deleguar më shumë autoritet dhe përgjegjësi të qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave, pat hartuar dhe miratuar në kuvend, Planin për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2026 brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave korrespondon me ligjin për mbeturinat dhe Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave si një plan afat mesëm.

Komuna e Vushtrrisë në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të implementimit të Planit Lokal, si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave, përveç krijimit të mekanizmit institucional (emërimit të zyrtarit për menaxhim të mbetjeve dhe zyrës për inkasim) dhe mekanizmit financiar (planifikimin e taksës për mbeturina si e hyrë komunale), ka arritur që të bëjë:

- zbatimin e Planit të ri operativ që ka rezultuar me; vazhdimin e kontraktimit të shërbimit me Ndërmarrja Publike Lokale „Përparimi” për tërë territorin e komunës, vazhdimin e mbledhjes së taksës për mbeturina si e hyrë komunale për vitin 2024, menaxhimi i softwerit pra sistemit të menaxhimit të të dhënave së bashku me listën e ekonomive familjare, profilizimin e klientëve, mënyrën e llogaritjes së kostos dhe nevojave financiare, shpërndarjen e faturës, mënyrën e pagesës, fushatën e vetëdijesimit publik, si dhe në ndërkohë verifikimin e fizibilitetit të projektit,
- zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohet në deponi përmes promovimit dhe praktikimit të ndarjes së mbeturinave që në burim, për zonën e përzgjedhur në qytet me 1500 ekonomi familjare, e cila sasi është duke u paketuar në Qendrën për paketim në Bukosh.
- projekti për ndarjen e mbetjeve në burim në të gjitha institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë.

Gjithashtu është hartuar Raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2023 përmes platformës elektronike të instaluar nga AMM (Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit) dhe GIZ. Gjatë periudhës janar – shtator 2024 nga shkalla e gjenerimit të mbetjeve janë grumbulluar, transportuar dhe deponuar në deponinë në Mirashë 15304.58 ton mbetje.

Tërë këto aktivitete kanë qenë të mbështetura nga konsulenca e vazhdueshme e GIZ-së përmes marrëveshjes së mirëkuptimit me ç'rast përfitimet e Komunës së Vushtrrisë kanë qenë shumë të mëdha. Përveç asistencës së vazhdueshme teknike përmes konsulentëve të angazhuar, është bërë hartimi i nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të tri komunave të regjionit duke përfshirë Komunën e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skenderajt, me çrast është hartuar Draft Plani Ndërkomunal dhe Draft - Marrëveshja për bashkëpunim ndërkomunal.

Po ashtu me organizatën Let's Do It- Ta Pastrojmë Kosovën, dhe me klubet e gjelberta kemi marrë aksion për pastrimin e mbeturinave dhe mbjelljen e drunjeve dekorativ, duke kontribuar për një mjedis të pastër dhe me të gjelbër. Aksioni u përqendruar në hapsirat përreth shëtitores "Enver Zymberi", ku pastruam mbeturina dhe mbollëm 25 drunjë dekorativ, duke i shtuar vlere natyrore në zonë.

Ndërsa sa i përket deponive ilegale, komuna së bashku me Ndërmarrja Publike Lokale, "Përparimi" në kuadër të aktivitetit për eliminimin e deponive ilegale, ka bërë eliminimin e disa deponive ilegale, me çrast aktualisht kemi vetëm 4 deponi ilegale të mëdha sepse pas shtrirjes së shërbimit në tërë territorin e komunës është bërë eliminim i qëndrueshëm i tyre.

Pra tërë këto aktivitete përbëjnë fushatën më të madhe mjedisore që për synim kanë pasur mbulueshmërinë me shërbim të tërë territorit të Komunës së Vushtrrisë, eliminimin e deponive ilegale, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbetjeve që deponohen, përmes promovimit të ndarjes së tyre në burim dhe procesit të kompostimit.

Shtojcë e informatës:

- *Raporti vjetor i dërguar në AMM për vitin 2023*



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIS

DATE: 11.11.2024

PËR: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

PROPOZUES: Kryetari i Komunës, z. Ferit Idrizi 

HARTUES: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, drejtor z. Isuf Jashari 

TEMA: Propozim-vendim

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja "d", nenit 40, paragrafi 2 pika "c" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe neni 9 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimit në Pronën e Paluajtshme (Ligji Nr. 08/L-224), si dhe në bazë të nenit 19, paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë: **29.11.2024** merr këtë:

VENDIM PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË PRONAVE

1. Me këtë vendim bëhet caktimi i normave tatimore për të gjitha kategoritë e pronave me përjashtim të kategorisë pronë publike, dhe atë si në vijim:

Lloji i pronës	Norma e tatimit në %
Pronë rezidenciale (banesë-apartmant)	0,20
Njësi rezidenciale-parcelë	0,12
Pronë rezidenciale - shtëpi	0.20
Pronë komerciale	0.21
Njësi komerciale-parcelë	0,18
Pronë industriale	0.20
Njësi industriale-parcelë	0,18
Pronë bujqësore	0.10

Njësi bujqësore-parcelë	0,10
Njësi pyjore parcelë	0,12
Pronat e pa-meremetuara dhe jo të gatshme për banim	0.15
Garazhet	0.15
Objektet e braktisura	0.15
Pronat komerciale (pishinat, fushat sportive etj).	0.21
Pronat e pa-meremetuara dhe jo të gatshme komerciale	0.20

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Tatimit në Pronën e Paluajtshme, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, karshi aprovimit të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, nga ana e kuvendit, është e obliguar të procedoj me propozim për aprovimin e nivelit të normave të tatimit në pronën e paluajtshme konform dispozitave dhe kritereve të përcaktuar me dispozitat ligjore.

Nga të cekurat më lartë i propozojmë kuvendit të komunës që ta aprovoj këtë propozim-vendim si në dispozitiv.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

DATË/DATA/DATE:	19 nëntor 2024
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	Znj. Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për shfuqizim të aktit komunal

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Bazuar në vlerësimet ligjore të bëra nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në ç' rast është kërkuar të rishqyrtohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.121/24 i datës 27.06.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Futbollit "Vushtrria", i cili është konstatuar se në nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryesuesja e Kuvendit duke marr për bazë këto rekomandime si dhe duke përmbushur obligimet ligjore që burojnë nga legjislacioni nga fusha e vetëqeverisjes lokale i propozon Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që ta shfuqizoj aktin-vendimin në fjalë.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qytëri e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhivo - Archive

№. Prot. / No. Prot. 1720-1/2024
 Data / Datum 02/08/2024
 PRISHTINEJA



MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
 Ministry of Local Government Administration

Data / Datum 03-08-2024

-vi- 020-431/10

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrusë	
Kopje:	Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës	
	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogjani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
	Arton Ahmeti, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Enis Spahiu, Drejtorë i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 26.08.2024
Zyrtarët përgjegjës:		Referencë: 181/2024
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Shqiptar Ibra, Zyrtar i Lartë Ligjor për Përafrim me Acquis, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
3. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vushtrrisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Idrizi,
I nderuari Kryesuese znj. Basholli Latifi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Pushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendim Nr. 121/24 për përkrahje financiare për Klubin e Futbollit "Vushtrria"</i>
<i>I miratuar më 27.06.2024</i>
<i>I parashtruar në MAPL më 01.07.2024</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 05.07.2024</i>
<i>Kërkesa për informata shtesë nga Ministria për Komunën e dërguar me datë 23.07.2024</i>
<i>Informatat shtesë të pranuar me datë 05.08.2024</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtë e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Vushtrisë, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Vushtrisë, me anë të aktit komunal që është subjekte të shqyrtimit, synon përkrahjen financiare të Klubit të Futbollit "Vushtrria",
2. Përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtë e tutje referuar si "LMFPP") dhe Ligjin Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7 **Burimet Financiare Komunale**

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë **dispozitat e aplikueshme të LMFPP** gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Ajo që i faktorizon edhe më shumë detyrimet e përcaktuara me dispozitat e LMPPP-së është neni 81 i LMPPP-së, në të cilin precizohet që në rastet kur ky ligj ka mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, dispozitat e LMPPP-së kanë përparësi, sikurse përshkruhet më poshtë:

Neni 81

Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraparak/Zbatueshmëria

81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, **dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. [theks i shtuar]**

4. Në rrjedhë të kësaj, LMPPP konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfilltë të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parasë publike në veçanti.
5. Në kuptim të shpenzimit të rregullt të parasë publike, neni 17 i LMPPP-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga **fondët e ndarë dhe të alokuara [theks i shtuar]**.
6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin me Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Vushtrisë, dhe komuna nuk ka mjete të lira tek nën-programi shërbimet kulturore për zbatimin e këtij vendimi.
7. Për më tepër, akti komunal i plotëson kriterin për t'u nënshtruar rregullave të Ndhmës Shtetërore të përcaktuara me Ligjin Nr.05 /L-100 për Ndhmën Shtetërore (LNSH), gjegjësisht nenit 7 dhe nenit 11, si në vijim:

Nenin 7: Ndhma "De Minimis" të LNSH, nëse kemi të bëjmë me përfitime në vlerë deri në 200,000 EUR (për 3 vite fiskale, për secilin subjekt afarist), dhe kështu sipas Nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2020 Për Ndhmën "De Minimis", institucioni dhënës obligohet që brenda 15 ditësh pas dhënies së ndihmës të raportojë nëpërmjet formularit të njoftimit konform Shtojcës 1 dhe 2 të Rregullores, në Departamentin e Ndhmës Shtetërore.

Nenin 11: Njoftimi për ndihmë shtetërore të LNSH, për vlera tjera, dhe kështu sipas Rregullores (QRK) Nr. 19/2018, për Procedurat dhe Format e Njoftimit për Ndhmën Shtetërore, institucioni dhënës obligohet të bëjë njoftimin e Ndhmës në Departamentin e Ndhmës Shtetërore, duke plotësuar formularët e njoftimit (pjesë shoqëruese të kësaj Rregullore), me kusht që ndihma e njoftuar nuk krijon efekt para autorizimit nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore.

8. Për financimin publik të OJQ-ve, në gamën legjislative të Ministrisë evidentohen si relevante dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (këtej e tutje referuar si "Rregullore për Financimin e OJQ-ve").

Rrjedhimisht, dispozitat e kësaj Rregullore janë të zbatueshme dhe relevante për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal në këtë vit fiskal.

9. Ministria me datë 23.07.2024 ka dërguar shkresë tek Komuna e Vushtrrisë për të marrë më shumë informata në lidhje me statusin e organizatave përfituese të subvencionit pasi që ka evidentuar që përfituesit kanë statusin e Organizatës Jo-Qeveritare (OJQ) në Sistemin Elektronik të Organizatave Jo-Qeveritare (SEOJQ).
10. Në rastin konkret, Ministria me datë 05.08.2024 ka pranuar informatat shtesë të kërkuara përmes komunikimit elektronik nga Komuna e Vushtrrisë me ç'rast është informuar që organiza përfituese është e regjistruar si OJQ. Më tutje, Komuna ka konstatuar me rastin e ndarjes së mjeteve financiare sipas aktit komunal nuk janë zbatuar procedurat e Rregullores 04/2017.
11. Ministria pas shqyrtimit të aktit komunal dhe informatave shtesë të siguruara nga Komuna e Vushtrrisë konstaton se akti komunal për ndarjen e subvencioneve për klubet sportive janë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores 04/2017. Kjo sepse fushëveprimi i Rregullores përfshin të gjitha strukturat e organizatave buxhefore, e në këtë rast edhe Kuvendit Komunal, dhe rrjedhimisht do të duhej të respektohen dispozitat e rregullores përgjatë përzgjedhjes së organizatave përfituese.
12. **Rrjedhimisht, Ministria vlerëson se akti komunal është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Ministria kërkon nga Komuna e Vushtrrisë ndërmarrjen e veprimeve konkrete, brenda 30 ditëve nga data e pranimin të kërkesës për rishqyrtim të aktit, në mënyrë që masa e përcaktuar me aktin e komunës të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi.**

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Vushtrrisë, dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRA

Bl. Nr. / Br. 121/24

Nr. i fq. / Br. st. - 1 -

Data / Datum 27.06.2024

VUSHTRRI - VUČITRA



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës – Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (KKV) Nr. 03/2023 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë, OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **27 qershor 2024** merr këtë:

V E N D I M

PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR KLUBIN E FUTBOLLIT “VUSHTRRIA”

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë prej njëqind mijë euro (100,000.00 €), për Klubin e Futbollit “Vushtrria”, në Vushtri.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Në mungesë të mjeteve në këtë drejtori, do të sigurohen nga njësitë e tjera buxhetore, ku ka mjete të lira.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 204/24

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 19.11.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

DATË/DATA/DATE:	19 nëntor 2024
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	Znj. Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për shfuqizim të aktit komunal

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Bazuar në vlerësimet ligjore të bëra nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në ç' rast është kërkuar të rishqyrtohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. protokollit nr.153/24 i datës 25.07.2024 për ofrimin e përkrahjes financiare për Klubin e Hendbollit KHF "Samadrexha", i cili është konstatuar se në nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryesuesja e Kuvendit duke marr për bazë këto rekomandime si dhe duke përmbushur obligimet ligjore që burojnë nga legjislacioni nga fusha e vetëqeverisjes lokale i propozon Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që ta shfuqizoj aktin-vendimin në fjalë.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

№. Prot. / Prot. No.: 1940-1/2024
 Data / Datum: 03/09/2024

PRISHTINE/ZA



HYRJESE DOKUMENTI
 Nr. Dokumenti: 03-09-2024
 Data: 03.09.2024
 -VI- 02-499/2

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë	
Kopje:	Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogjani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Artan Ahmeti, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Enis Spahiu, Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Data: 26.08.2024
Zyrtarët përgjegjës:	Shqiptar Ibra, Zyrtar i Lartë Ligjor për Përafrim me Acquis, Departamenti Ligjor - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Këmete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Referencë: 188/2024
Lënda:	Kërkesë për informata shitesë në lidhje me aktin e Komunës së Vushtrrisë	
Lloji i aktit:	Kërkesë për informata shitesë	

I nderuari Kryetar z. Idrizi,
I nderuari Kryesuesë z.nj. Basholli Latifi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si ne vijim:

<i>Vendim Nr. 153/24 për përkrahje financiare për klubin KHF "Samadrexha"</i>
<i>I miratuar më 25.07.2024</i>
<i>I parashtruar në MAPL më 31.07.2024</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.08.2024</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Vushtrrisë, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Vushtrrisë, me anë të vendimit që është subjekt i shqyrtimit, synon përkrahjen financiare në shumë prej njëqind mijë euro për Klubin e Futbollit "Samadrexha".
2. Duke pasë këtë parasysh, Komuna nuk ka paraqitur dokumentet që dëshmojnë se janë ndjekur procedurat e rregullores MF -- NR -- 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Mirëpo, Klubi i Futbollit "Samadrexha" në sistemin elektronik të organizatave jo-qeveritare shfaqet si organizatë jo-qeveritare. Tutje, tek pika 1 e aktit komunal iu është referuar shumës së ndarë për organizatën në fjalë "dhjetë mijë euro" me fjalë ndërsa me numra shumës iu është referuar si "(30,000.00)" si dhe duhet të ceket dhe nënprogrami buxhetor riga i cili do të bëhet zbatimi i vendimit.
4. Për më tepër, akti komunal i plotëson kriterin për t'iu nënshtruar rregullave të Ndhmës Shtetërore të përcaktuara me Ligjin Nr.05 /L-100 për Ndhmën Shtetërore (LNSH), gjegjësisht nenit 7 dhe nenit 11, si në vijim:

Nenin 7: Ndhma "De Minimis" të LNSH, nëse kemi të bëjmë me përfitime në vlerë deri në 200,000 EUR (për 3 vite fiskale, për secilin subjekt afarist), dhe kështu sipas Nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2020 Për Ndhmën "De Minimis", institucioni dhënës obligohet që brenda 15 ditësh pas dhënies së ndihmës të raportojë nëpërmjet formularit të njohimit konform Shtojcës 1 dhe 2 të Rregullores, në Departamentin e Ndhmës Shtetërore.

Nenin 11: Njoftimi për ndihmë shtetërore të LNSH, për vlera tjera, dhe kështu sipas Rregullores (QRK) Nr. 19/2018, për Procedurat dhe Format e Njoftimit për Ndihmën Shtetërore, institucioni dhënës obligohet të bëjë njoftimin e Ndihmës në Departamentin e Ndihmës Shtetërore, duke plotësuar formularët e njoftimit (pjesë shoqëruese të kësaj Rregullore), me kusht që ndihma e njoftuar nuk krijon efekt para autorizimit nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

5. Po ashtu, akti komunal nuk cëkë nenprogramin buxhetor se nga i cili do të përdoren mjetet për realizimin e aktit.
6. Nga ajo që u tha më lartë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konsideron se duhet të plotësohet/ndryshohet akti komunal për të përcaktuar shumën e mjeteve që synohet të transferohen tek organizata përfituese si dhe të përcaktoj nënprogramin buxhetor nga i cili do të barten mjetet. Po ashtu, Ministria nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të shqyrtuar ligjshmërinë e këtij akti andaj kërkon nga Komuna e Vushtrrisë plotësimin e të dhënave, gjegjësisht, dokumentet që dëshmojnë se janë ndjekur procedurat e rregullores 04/2017.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunes së Vushtrrisë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br. 153/24
Nr. i fq. / Br. sh. - 1 -
Data: / Datum 25. 07. 2024
VUSHTRRI - VUČITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës – Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (KKV) Nr. 03/2023 për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë, OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 25 korrik 2024 merr këtë:

V E N D I M
PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR KLUBIN E HENDBOLLIT KHF
“SAMADREXHA”

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë tri dhjetë mijë euro (30,000.00 €), për Klubin e Hendbollit KHF “Samadrexha” në Vushtrri.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit (850) i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Në mungesë të mjeteve në këtë drejtori, do të sigurohen nga njësitet e tjera buxhetore, ku ka mjete të lira.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

